TRANSLATION DEPARTMENT
DAWAT-E-ISLAMI

Metoda e Abdestit

(Sipas medh'hebit Hanefi)



Këtë libër e ka përkthyer në shqip
Departamenti i Përkthimit
(Translation Department)

Shejkhu i Tarikatit, Emiri i Ehli Sunnetit,
Themeluesi i Dawat-e-Islami 'Al-lameh Meulana Ebu Bilal

MUHAMMED ILJAS

Attar Kadiri Razavi

وُضُو کا طَرِیقہ (حَنَفی)

Wudu ka Tareeqah (Hanafi)

Metoda e Abdestit (Sipas medh'hebit Hanefi)

Ky libër është shkruar nga Shejkhu i Tarikatit, Emiri i Ehli Sunnetit, themeluesi i Dawat-e-Islami 'Al-lameh Meulana Ebu Bilal Muhammed Iljas Attar Kadiri Razavi دَامَتْ بَرَكَاتُهُمُ الْعَالِيَه (damet berraketuhuhu'l-'alijeh) në Urdu. Këtë libër e ka përkthyer në shqip Departamenti i Përkthimit (Majlis-e-Tarajim). Nëse gjeni ndonjë gabim në përkthim ose kompozim, ju lutemi informoni Departamentin e Përkthimit në adresën postare ose e-mailin e mëposhtëm me qëllim për të fituar shpërblim [sevap].

Departamenti i Përkthimit (Dawat-e-Islami)

Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah Mahllah Saudagran, Purani Sabzi Mandi, Bab-ul-Madinah, Karachi, Pakistan

UNA: ☎ +92-21-111-25-26-92 – Ext. 7213

Email: ✉ translation@dawateislami.net

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعٰلَمِيْنَ ۘ وَالصَّلٰوةُ وَالسَّلَامُ عَلٰى خَاتَمِ النَّبِيّٖنَ ۘ
اَمَّا بَعْدُ فَاَعُوْذُ بِاللّٰهِ مِنَ الشَّيْطٰنِ الرَّجِيْمِ ۘ بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ ۘ

Duaja për Leximin e Librit

Lexoni Duanë (lutjen) e mëposhtme përpara se të studioni një libër fetar ose një mësim Islam; me lejen e All-llahut عَزَّوَجَلَّ, do të mbani mend gjithçka që studioni:

اَللّٰهُمَّ افْتَحْ عَلَيْنَا حِكْمَتَكَ وَانْشُرْ عَلَيْنَا رَحْمَتَكَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْاِكْرَام

Përkthimi:

O All-llahu im عَزَّوَجَلَّ! Na i hap dyert e diturisë dhe urtësisë dhe na mëshiro! O Zoti i Madhështisë dhe Nderimit!

(El-Mustetraf, vëll. 1, fq. 40)

Shënim: Dërgoni Salavate mbi Pejgamberin صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم një herë para dhe pas Duasë.

Përmbajtja

Duaja për Leximin e Librit ii

Metoda e Abdestit 1

(Sipas Medh'hebit Hanefi) 1

Vlera e Salavateve mbi Pejgamberin ﷺ 1

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All-llahut qofshin mbi Muhammedin!) 1

Dashuria e Hazreti 'Uthmanit për Pejgamberin e Lavdishëm ﷺ 1

Histori mbi shlyerjen e gjynaheve 2

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All-llahut qofshin mbi Muhammedin!) 3

Shpërblimi për Abdestin 3

Pastrimi i gjithë trupit 4

Vlera e të fjeturit me Abdest 4

Kush vdes me Abdest quhet dëshmor 4

Këshilla për shmangien e problemeve 5

Shtatë përfitime të qëndrimit me Abdest gjatë gjithë kohës 5

Shpërblimi i dyfishtë 5

Histori mbi marrjen e Abdestit në të ftohtë 6

Metoda e Abdestit (Sipas Medh'hebit Hanefi) 6

Shërimi i 70 sëmundjeve në ujin e mbetur të Abdestit 9

(Dërgoni salavat mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All_llahut qofshin mbi Muhammedin!) 9
Hapen të tetë portat e Xhennetit 9
Shikimi nuk dobësohet kurrë 10
Vlerat e recitimit të Sures El-Kadr 3 herë pas Abdestit 10
Duaja që thuhet pas Abdestit 10
(Dërgoni salavat mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All_llahut qofshin mbi Muhammedin!) 11
Katër Farzet e Abdestit 11
Përkufizimi i 'larjes' 11
Katërmbëdhjetë Sunnetet e Abdestit 11
Njëzet e nëntë Mustehabe (veprime të pëlqyeshme) të Abdestit 12
Gjashtëmbëdhjetë Mekruhe (veprime të papëlqyeshme) gjatë Abdestit ... 15
Sqarim në lidhje me ujin e ngrohur nga dielli 16
Rregull i rëndësishëm për ujin Musta'mel (e përdorur) 17
Abdesti me ujë të turbullt 18
Kujdes për ata që hanë Paan (gjethe beteli)! 18
Një këshillë Tesavvufi Medinase madhështore 19
Pesë rregulla mbi gjakderdhjen nga një plagë 20
Çarjet e lëkurës për shkak të të ftohtit intensiv 21
Rregulli për Abdestin në rastin e përdorimit të kënasë dhe kohlit (rimelit) 21
A e prishin injeksionet Abdestin? 21

Lotët e syrit të sëmurë 22
Lëngu i pastër dhe i papastër 22
Flluskat dhe puçrrat..... 23
Kur e prish të vjellët Abdestin?..... 23
Rregullat rreth të qeshurit..... 23
A e prish Abdestin shikimi i pjesëve intime të dikujt? 24
Abdesti gjatë Guslit është i mjaftueshëm..... 25
Gjaku në pështymë..... 25
Pesë rregulla mbi pasigurinë në Abdest 25
Pozicionet e gjumit që e prishin ose nuk e prishin Abdestin 26
Dhjetë pozicione gjumi që nuk e prishin Abdestin: 26
Dhjetë pozicione gjumi që e prishin Abdestin: 28
Gjumi dhe Abdesti i Pejgamberëve të Bekuar 29
Abdest'hanet në Mesxhid..... 29
Ndërtimi i një Abdest'haneje brenda shtëpisë 29
Plani i ndërtimit për një Abdest'hane..... 30
Nëntë perla Medinase rreth Abdest'hanes 31
Gjashtë rregulla për këdo që nuk mund ta mbajë Abdestin e tij..... 32
Shtatë vendime të ndryshme 35
Vendim i rëndësishëm mbi prekjen e një letre me një Ajet Kur'anor në të 36
Nuk lejohet prekja e Kur'anit të Lavdishëm nga asnjë anë pa Abdest..... 36
Shpërdorimi i ujit gjatë Abdestit..... 37
1. Shpërdorimi në përrua 37

Fetvaja e A'la Hadretit 37
Tefsiri (komentari) i Mufti Ahmed Jar Khanit 38
2. Mos e shpërdoroni ujin 38
3. Shpërdorimi është vepër djallëzore 38
4. Duke kërkuar një pallat të bardhë në Xhennet? 39
E keqja dhe padrejtësia 39
Shpërdorimi është gjynah vetëm në dy raste 39
Mësoni Abdestin praktikisht 40
Shpërdorimi i ujit të Mesxhidit dhe Medresesë 41
Shtatë udhëzime nga A'la Hadreti për të shmangur shpërdorimin 41
Katërmbëdhjetë perla Medinase për të shmangur shpërdorimin e ujit 43
Një buqetë me 40 perla Medinase 46
Kushdo që vdes me Abdest është dëshmor 51
Këshillë për lindje të lehtë (Lulja e Zonjës Merjeme) 52
Lindje pa operacion 52

اَلْحَمْدُ لِلّٰهِ رَبِّ الْعٰلَمِيْنَ ؕ وَ الصَّلٰوةُ وَ السَّلَامُ عَلٰى خَاتَمِ النَّبِيّٖنَ ؕ
اَمَّا بَعْدُ فَاَعُوْذُ بِاللّٰهِ مِنَ الشَّيْطٰنِ الرَّجِيْمِ ؕ بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ ؕ

Metoda e Abdestit [1]

(Sipas Medh'hebit Hanefi)

Ju lutemi lexojeni këtë broshurë nga fillimi në fund. Ka shumë mundësi që do të zbuloni shumë gjëra që i keni ditur gabim.

Vlera e Salavateve mbi Pejgamberin ﷺ

Pejgamberi i Dashur dhe i Bekuar صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم ka thënë: 'Kushdo që, nga dashuria dhe përkushtimi për mua, dërgon tri herë salavate mbi mua gjatë ditës dhe tri herë gjatë natës, All-llahu عَزَّوَجَلَّ patjetër që do t'ia falë mëkatet e kryera gjatë asaj dite dhe nate.' *(El-Mu'xhemu'l-Kebir, vëll. 18, fq. 362, Hadithi 928)*

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All-llahut qofshin mbi Muhammedin!)

Dashuria e Hazreti 'Uthmanit për Pejgamberin e Lavdishëm ﷺ

Sejjiduna Hazreti 'Uthmani رَضِیَ اللّٰهُ عَنْهُ një ditë i kërkoi dikujt t'i sillte ujë në një vend të caktuar dhe mori Abdest. Më pas, ai رَضِیَ اللّٰهُ عَنْهُ buzëqeshi papritur dhe i pyeti shokët e tij nëse e dinin se përse kishte buzëqeshur. Duke u përgjigjur vetë, ai رَضِیَ اللّٰهُ عَنْهُ tha: "Një ditë, Pejgamberi i Nderuar dhe i Bekuar صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم mori Abdest; pastaj buzëqeshi dhe i pyeti shokët e tij: 'A e dini pse buzëqesha?' Rrasuli I Nderuar صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم u

[1] Arabisht – وضوء- Vudhu'

përgjigj vetë: 'Kur një njeri lan duart gjatë Abdestit, , gjynahet e duarve të tij shlyhen; kur lan fytyrën, shlyhen edhe gjynahet e fytyrës së tij; kur bën mes'h (fshin me dorë të lagur) kokën, shlyhen edhe gjynahet e kokës së tij, dhe kur lan këmbët, shlyhen edhe gjynahet e këmbëve të tij.'

(Musned Imam Ahmed Bin Hanbel, vëll. 1, fq. 130, Hadithi 415)

Wudu ker kay khandaan huway shah-e-'Usman
Kaha: Kyun tabassum bhala ker raha hoon?
Jawab-e-suwal-e-mukhatib diya phir
Kisi ki 'ada' ko ada ker raha hoon
Pasi mori Abdest, buzëqeshi prijësi Uthman,
"Vallë pse buzëqesh kështu?" – pyeti ata pranë.
Përgjigjen kësaj pyetjeje e dha vetë plot hijeshi:
"Metodën e Tij të shtrenjtë, po e jetësoj tani."

Të dashur vëllezër muslimanë! A e vutë re me sa pasion Sahabet e lavdishëm رَضِیَ اللّٰہُ عَنۡہُم i imituan Sunnetet si dhe çdo veprim të Pejgamberit të Nderuar صَلَّی اللّٰہُ عَلَیۡہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم? Ky transmetim na ofron gjithashtu edhe një ilaç për gjynahet. اَلۡحَمۡدُ لِلّٰہ عَزَّوَجَلَّ, shpëlarja e gojës rezulton në shlyerjen e gjynaheve të gojës; shpërlarja e hundës rezulton në shlyerjen e gjynaheve të hundës; larja e fytyrës rezulton në shlyerjen e gjynaheve të fytyrës, përfshirë ata të qerpikëve; larja e duarve rezulton në shlyerjen e gjynaheve të duarve dhe të atyre poshtë thonjve; mes'hi i kokës (dhe veshëve) rezulton në shlyerjen e mëkateve të kokës dhe veshëve, dhe larja e këmbëve rezulton në shlyerjen e mëkateve të dy këmbëve, përfshirë ata poshtë thonjve të këmbëve.

Histori mbi shlyerjen e gjynaheve

اَلۡحَمۡدُ لِلّٰہ عَزَّوَجَلَّ! Gjynahet e një muslimani shlyhen kur ai merr Abdest. Ja një shembull që forcon besimin: 'Al-lameh 'Abdu'l-Vehhab Sha'rani رَحۡمَۃُ اللّٰہِ عَلَیۡہ transmeton: "Njëherë Hirësia e Tij, Sejjiduna Imam A'dham Ebu Hanife رَحۡمَۃُ اللّٰہِ عَلَیۡہ u ndodh në Abdest'hanen e Xhamisë së Kufes, ku vuri re një të ri duke marrë Abdest. Nga trupi i të riut pikuan piklat e

ujit me të cilin ai po merrte Abdest. Imami i madh رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه i tha: 'Bir! Pendohu për mosbindjen ndaj prindërve të tu.' 'U pendova.' - u përgjigj menjëherë i riu.

Imami رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه i nderuar pas pak momentesh vuri re piklat e ujit që pikuan nga trupi i një burri tjetër dhe i tha: 'O vëlla! Pendohu për zinanë (imoralitetin).' 'U pendova.'- u përgjigj ai. Imami رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه vuri re më pas piklat e ujit që pikuan nga trupi i një personi të tretë dhe i tha: 'Pendohu për pirjen e verës dhe dëgjimin e muzikës.' 'U pendova.'- u përgjigj ai.

Sejjiduna Imam A'dham Ebu Hanifja رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ishte i pajisur me fuqinë e Keshfit (depërtimit shpirtëror) dhe ishte në gjendje të shihte gjynahet e fshehura të njerëzve. Ai iu lut All-llahut عَزَّوَجَلَّ që ta humbiste këtë fuqi. All-llahu عَزَّوَجَلَّ ia pranoi duanë dhe që pas asaj ai nisi të mos i shikonte dot më gjynahet e njerëzve duke u pastruar gjatë marrjes së Abdestit.

(El-Mizanu'l-Kubra, vëll. 1, fq. 130)

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All-llahut qofshin mbi Muhammedin!)

Shpërblimi për Abdestin

Veprat varen nga nijetet: Nuk ka shpërblim për veprën e kryer pa nijet të mirë. I njëjti rregull vlen edhe për Abdestin. Në faqen 292 të vëllimit të parë të librit prej 1250 faqesh 'Bahar-e-Shari'at', botuar nga Maktaba-tul-Medinah, departamenti botues i Dawat-e-Islami, thuhet: "Për të fituar shpërblim për Abdestin, duhet ta kryeni atë me nijetin e kryerjes së urdhrit Hyjnor; përndryshe, Abdesti juaj do të jetë i vlefshëm, por nuk do të fitoni shpërblim për të."

A'la Hazreti Ahmed Raza Khan رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: "Ai që e bën zakon të marrë Abdest pa bërë nijet konsiderohet gjynahqar, sepse nijeti për Abdest është Sunnet Muekkedeh (sunnet i fortë).

(Fetava Razavijjeh, vëll. 4, fq. 616)

Pastrimi i gjithë trupit

Këtu është një përmbledhje e dy Haditheve të Rrasulull-llahut të Dashur صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم: Nëse dikush e fillon Abdestin me 'بِسْمِ اللّٰه', atëherë i gjithë trupi i tij, nga koka deri te këmbët, pastrohet; por nëse nuk thotë 'بِسْمِ اللّٰه' para Abdestit, atëherë pastrohen vetëm pjesët e lara të trupit të tij.

(Sunen Dar Kutni, vëll. 1, fq. 108, 109, Hadithet 228, 229)

Sejjiduna Ebu Hurejra رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ transmeton se: "Pejgamberi I Dashur dhe i Bekuar صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم ka thënë: 'O Ebu Hurejre! Kur merr Abdest, lexo 'بِسْمِ اللّٰهِ وَالْحَمْدُ لِلّٰه' (Bismil-lahi ue'l-hamdu li'l-lah), engjëjt shkrues (Kiramen Katibin) do të vazhdojnë të regjistrojnë vepra të mira për ty për aq kohë sa të qëndrosh me Abdest.'

(El-Mu'xhemu's-Sagir li't-Taberani, vëll. 1, fq. 73, Hadithi 186)

Vlera e të fjeturit me Abdest

Një Hadith i bekuar thotë: 'Kushdo që fle me Abdest është njësoj sikur një adhurues që mban agjërim (saum).'

(Kenzu'l-'Ummal, vëll. 9, fq. 123, Hadithi 25994)

Kush vdes me Abdest quhet dëshmor

Rrasulull-llahu i Dashur صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم i tha Sejjiduna Enesit رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ: "Bir! Nëse ke mundësi të qëndrosh me Abdest gjatë gjithë kohës, atëherë bëje këtë, sepse për këdo që është me Abdest kur shpirti i tij merret nga engjëlli i vdekjes regjistrohet grada e dëshmorit.'

(Shu'abu'l-Iman, vëll. 3, fq. 29, Hadithi 2783)

Hazreti A'la, Imam Ahmed Raza Khan رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: "Është Mustehab (e pëlqyeshme) të qëndrosh me Abdest gjatë gjithë kohës.'

Këshilla për shmangien e problemeve

All-llahu عَزَّوَجَلَّ i tha Pejgamberit të Tij të dashur, Sejjiduna Musait عَلَيْهِ السَّلَام: "O Musa! Nëse të godet ndonjë fatkeqësi kur nuk je me Abdest, fajësoje veten.

(Shu'abu'l-Iman, vëll. 3, fq. 29, Hadithi 2782)

Në Fetava Razavijjeh thuhet: "Qëndrimi me Abdest gjatë gjithë kohës është Sunnet i Islamit."

(Fetava Razavijjeh, vëll. 1, fq. 702)

Shtatë përfitime të qëndrimit me Abdest gjatë gjithë kohës

Mësuesi im, Imam i Ehlu's-Sunnetit Imam Ahmed Raza Khan رَحْمَةُ اللهِ عَلَيْه thotë: "Disa dijetarë kanë thënë: 'Kushdo që qëndron me Abdest gjatë gjithë kohës do të shpërblehet me shtatë mirësi nga All-llahu عَزَّوَجَلَّ:

- Engjëjt do të jenë të etur ta shoqërojnë.
- Pena e shenjtë do të shkruajë vazhdimisht vepra të mira për të.
- Pjesët e trupit të tij do të bëjnë Tesbih (madhërim të All-llahut عَزَّوَجَلَّ).
- Ai nuk do ta humbasë kurrë tekbirin fillestar të Namazit.
- Kur fle, All-llahu عَزَّوَجَلَّ do të dërgojë disa engjëj për ta mbrojtur nga e keqja e xhinëve dhe njerëzve.
- Do të ketë një vdekje të lehtë.
- Do të qëndrojë në mbrojtjen e All-llahut عَزَّوَجَلَّ për aq kohë sa është me Abdest.

(Fetava Razavijjeh, fq. 702, 703)

Shpërblimi i dyfishtë

Pa dyshim që është e vështirë të merret Abdest kur është ftohtë, ose kur jemi të lodhur, ose kur vuajmë nga gripi, dhimbja e kokës apo ndonjë

sëmundje tjetër. Megjithatë, nëse dikush merr Abdest në këtë gjendje të papërshtatshme, atëherë sipas një Hadithi ai do të marrë shpërblim të dyfishtë.

(El-Mu'xhemu'l-Eusat, vëll. 4, fq. 106, Hadithi 5366)

Histori mbi marrjen e Abdestit në të ftohtë

Sejjiduna Hazreti 'Uthmani رَضِیَ اللّٰہُ عَنۡہُ i kërkoi shërbëtorit të tij Humranit t'i sillte ujë për të marrë Abdest jashtë në të ftohtë. Pasi Humrani solli ujin dhe Sejjiduna Hazreti 'Uthmani رَضِیَ اللّٰہُ عَنۡہُ lau fytyrën dhe duart, Humrani tha: "Të mjaftoftë All-llahu عَزَّوَجَلَّ! Është tmerrësisht ftohtë." Sejjiduna Hazreti 'Uthmani رَضِیَ اللّٰہُ عَنۡہُ u përgjigj: "Kam dëgjuar nga Rrasulull-llahu صَلَّی اللّٰہُ عَلَیۡہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم se nëse dikush merr një Abdest të plotë, All-llahu عَزَّوَجَلَّ do t'ia falë gjynahet e tij të mëparshme dhe të ardhshmet.'

(Musnedu'l-Bezzar, vëll. 2, fq. 75, Hadithi 422; Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 285)

Metoda e Abdestit (Sipas Medh'hebit Hanefi)

Gjatë marrjes së Abdestit është Mustehab (e pëlqyeshme) të ulesh në një ndenjëse të ngritur, me fytyrë nga Kibla. Bërja e nijetit për Abdest është Sunnet. Edhe pa nijet, Abdesti yt është i vlefshëm, por nuk do të shpërblehesh me sevape për të. Nijeti është një vendim i fortë që merret në zemrën tënde. Nijetin që e bën me zemër, është e pëlqyeshme ta shprehësh edhe me fjalë. Prandaj, duhet të thuash: "Po marr Abdest për të përmbushur një urdhër të All-llahut عَزَّوَجَلَّ dhe për tu pastruar.'

Lexoni në fillim 'بِسۡمِ اللّٰہ' (Bismil–lahi), sepse edhe kjo është Sunnet. Në fakt, duhet të thoni 'بِسۡمِ اللّٰہِ وَالۡحَمۡدُ لِلّٰہ' (Bismil–lahi ue'l–hamdu li'l–lahi), pasi engjëjt do të vazhdojnë të shkruajnë vepra të mira për ju për aq kohë sa vazhdoni të jeni me Abdest[1]. Pastaj lani të dy duart deri në kyçe tri herë (duke e mbyllur rubinetin) dhe bëni Khilal [dmth., kaloni gishtat e njërës

[1] El-Mu'xhemu's-Saghir li't-Taberani, vëll. 1, fq. 73, Hadithi 186

www.dawateislami.net

dorë midis hapësirave të gishtave të dorës tjetër, duke i fërkuar bashkë].

Pastroni dhëmbët duke përdorur Misvakun të paktën tri herë duke filluar nga dhëmbët e djathtë, pastaj të majtët, të sipërmit dhe të poshtmit; shpërlani Misvakun për secilën herë. Huxhxhetu'l-Islam, Sejjiduna Imam Muhammed Gazaliu رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: "Përdorni Misvakun, me nijetin për të pastruar gojën tuaj për recitimin e Kur'anit të Lavdishëm dhe për përmendjen e All-llahut عَزَّوَجَلَّ."[1]

Më pas shpërlani gojën tri herë duke marrë ujë me grushtin e dorës suaj të djathtë (duke e mbyllur rubinetin për çdo herë), duke u siguruar që uji të arrijë në të gjitha pjesët e gojës (deri në fyt) gjatë secilës herë. Gjithashtu, nëse nuk jeni duke agjëruar (Saum), bëni gargarë. Pastaj thithni ujë (aq sa mund të mbahet në gjysmën e grushtit të dorës suaj të djathtë) tri herë deri në pjesën e butë të hundës (me rubinetin e mbyllur çdo herë). Nëse nuk jeni duke mbajtur agjërim (Saum), atëherë thithni ujë deri në pjesën e sipërme të kockës së butë të brendshme të hundës. Tani pastroni hundën tuaj duke përdorur dorën tuaj të majtë (duke e mbyllur rubinetin) dhe futni gishtin tuaj më të vogël në vrimat e hundës.

Derdhni ujë mbi çdo pjesë të të gjithë fytyrës tuaj, nga pjesa e sipërme e ballit tuaj, dmth., nga vija e flokëve, deri poshtë mjekrës tuaj dhe nga njëri vesh te tjetri, tri herë. (Duke e mbyllur rubinetin) Bëjini Khilal mjekrës suaj, nëse keni, dhe nëse nuk jeni në Ihram (të Haxhit ose Umres) duke futur gishtat tuaj në mjekër nga poshtë dhe duke i nxjerrë përpara. Tani lani tri herë krahun tuaj të djathtë nga majat e gishtave tuaj deri në bërryl, duke e përfshirë edhe bërrylin dhe lani edhe krahun tuaj të majtë në të njëjtën mënyrë.

Është Mustehab të lahen krahët deri në gjysmën e pjesës së sipërme të tyre (mbi bërrylin). Shumica e njerëzve marrin një sasi të vogël uji në duart e tyre dhe e derdhin mbi krahët e tyre në drejtim të bërrylave, tri herë. Kjo përfshin rrezikun që uji të mos rrjedhë mbi anët e kyçit të dorës dhe bërrylit. Prandaj, lani krahët siç u përmend më lart. Tani nuk

[1] Ihjau'l-'Ulum, vëll. 1, fq. 182

www.dawateislami.net

ka nevojë të derdhni një grusht ujë mbi bërryl. Në fakt, bërja e kësaj (pa një justifikim të vlefshëm Sheriatik) është shpërdorim uji. Tani bëni mes'h (fshini) kokën (duke e mbyllur rubinetin). Duke përjashtuar gishtat tregues dhe gishtat e mëdhenj, bashkoni majat e tre gishtave të të dyja duarve dhe vendosini ato në lëkurën ose flokët e ballit. Lëvizni këta gishta (duke i shtypur butësisht) nga balli deri te qafa mbrapa, pa e prekur kokën me pëllëmbët e duarve (po vetëm gishtat). Tani duke i vendosur pëllëmbët në pjesën anësore të kokës, sillini pëllëmbët duke fshirë kokën anash nga pjesa e pasme e qafës deri tek balli para. Gjatë kësaj, gishtat tregues dhe gishtat e mëdhenj nuk duhet të prekin kokën fare.[1]

Tani përdorni gishtat tregues për të fshirë pjesët e brendshme të veshëve tuaj; gishtat e mëdhenj për të fshirë pjesët e pasme të veshëve tuaj; futni gishtat e vegjël në vrimat e veshëve tuaj dhe fshini pjesën e pasme të qafës suaj duke përdorur pjesët e pasme të gishtave të të dyja duarve. Disa njerëz fshijnë fytin, parakrahët e tyre tashmë të larë dhe kyçet e duarve të lara; kjo nuk është Sunnet. Duhet ta bëni zakon mbylljen mirë të rubinetin para se të bëni mes'h (fshini) kokën.

Është gjynah të shpërdorosh ujin duke e lënë rubinetin të hapur plotësisht ose pjesërisht pa asnjë arsye Sheriatike. Tani lani të dy këmbët nga tri herë, fillimisht të djathtën dhe pastaj të majtën, duke filluar nga majat e gishtërinjve deri sipër kyçeve të këmbëve. Është Mustahab të lani këmbët deri në gjysmën e tibias (pjesës mes gjurit dhe shputës së këmbës) tri herë. Është Sunnet të bëni Khilal (fërkoni) gishtat e të dyja këmbëve. (Rubineti duhet të mbahet i mbyllur gjatë Khilalit.) Metoda e fërkimit Mustahab është të filloni Khilalin nga gishti i vogël i këmbës së djathtë deri te gishti i madh, duke përdorur gishtin e vogël të dorës së majtë, dhe pastaj, duke bërë Khilalin nga gishti i madh i këmbës së majtë deri te gishti i vogël,

[1] Një metodë tjetër për bërjen mes'h (fshirjen e) kokës, veçanërisht më e përshtatshme për motrat muslimane, është si më poshtë: Për të përmbushur Sunnetin e mes'hit së plotë të kokës, është gjithashtu e mjaftueshme të vendosni gishtat në pjesën e përparme të kokës dhe pëllëmbët anash dhe thjesht t'i tërhiqni ato deri te qafa. *(Referuar nga Fetaua Razavijjeh, vëll. 4, fq. 621)*

duke përdorur të njëjtin gisht të vogël të dorës së majtë.

(Libra të përbashkët)

Huxh-xhetu'l-Islam, Sejjiduna Imam Muhammed Gazaliu رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: 'Ndërsa lani çdo pjesë të trupit, duhet të shpresoni se gjynahet e asaj pjese të trupit po fshihen.'

(Ihjau'l-'Ulum, vëll. 1, fq. 183, përmbledhur)

Shërimi i 70 sëmundjeve në ujin e mbetur të Abdestit

Pasi të keni përfunduar Abdestin duke përdorur një enë etj., duhet të ngriheni dhe të pini ujin e ngelur. Ky është shërim për sëmundjet. Mjeshtri im A'la Hadret, Imam i Ehlu's-Sunnetit, Mevlana Shah Imam Ahmed Raza Khan رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë në Fetava Razavijjeh, vëllimi 4, faqet 575 deri 576: Uji i mbetur i Abdestit është i shenjtë dhe i bekuar, dhe Pejgamberi i Nderuar صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم e pinte atë duke qëndruar në këmbë. Një Hadith thotë se pirja e tij shëron shtatëdhjetë sëmundje. Prandaj, në këtë drejtim, është i ngjashëm me ujin e Zemzemit. Istinxhaja (pastrimi pas nevojës) me këtë ujë është i papërshtatshëm.

Në kapitullin e 'edukatave të Abdestit' në librin 'Tenvir' thuhet: Me përfundimin e Abdestit tuaj, duhet të pini ujin e mbetur të Abdestit duke qëndruar në këmbë dhe me fytyrë nga Kibla. 'Al-lameh 'Abdul Gani Nabulusi رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: "Kam përjetuar që sa herë jam sëmurë, jam shëruar duke pirë ujin e mbetur të Abdestit. E bëj këtë duke i besuar këtij transmetimi autentik të përmendur në kapitullin 'shërimet nga Pejgamberi صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم '.

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e Allahut qofshin mbi Muhammedin!)

Hapen të tetë portat e Xhennetit

Një Hadith i shenjtë thotë: 'Nëse dikush merr Abdest siç duhet dhe më pas reciton Kelime Shehadetin duke shikuar drejt qiellit, të gjitha dyert

e Xhennetit do të hapen për të; ai mund të hyjë nga cilado që dëshiron.'

(Suneni Darimi, vëll. 1, fq. 196, Hadithi 716)

Shikimi nuk dobësohet kurrë

Kushdo që shikon drejt qiellit pas Abdestit dhe reciton Suren El-Kadr, nuk do të ketë kurrë shikim të dobët, إِنْ شَآءَ اللّٰه (me lejen e All–llahut) عَزَّوَجَلَّ.

(Mesa`ilu'l-Kur'an, fq. 291)

Vlerat e recitimit të Sures El-Kadr 3 herë pas Abdestit

Në një Hadith thuhet: "Kushdo që reciton Suren El-Kadr një herë pas Abdestit, është ndër të sinqertët (Siddikijun); kushdo që e reciton dy herë do të jetë ndër dëshmorët; dhe kushdo që e reciton tri herë, do të qëndrojë me Pejgamberët عَلَيْهِمُ الصَّلٰوةُ وَالسَّلَام (si dhuratë) nga All-llahu عَزَّوَجَلَّ në Ditën e Gjykimit.

(Kenzu'l-'Ummal, vëll. 9, fq. 132, nr. 26085; El-Havi li'l-Fetava li's-Sujuti, vëll. 1, fq. 402)

Duaja që thuhet pas Abdestit

(Salavat mbi Pejgamberin صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم një herë para dhe pas Duasë)

Nëse dikush reciton Duanë e mëposhtme pas Abdestit, ajo do të vuloset dhe do të ruhet nën 'Arsh dhe do t'i dorëzohet atij në Ditën e Gjykimit.

(Shu'abu'l-Iman, vëll. 3, fq. 21, nr. 2754)

سُبْحَانَكَ اللّٰهُمَّ وَبِحَمْدِكَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلٰهَ إِلَّا أَنْتَ أَسْتَغْفِرُكَ وَأَتُوبُ إِلَيْكَ

Përkthimi: O All-llahu im عَزَّوَجَلَّ! Ti je i Përsosur, të gjitha lavdet janë për Ty. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Teje. Kërkoj faljen Tënde dhe të pendohem Ty.

Recitoni gjithashtu Duanë e mëposhtme pas Abdestit:
(Salavat mbi Pejgamberin صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم një herë para dhe pas Duasë)

اَللّٰهُمَّ اجْعَلْنِیْ مِنَ التَّوَّابِیْنَ وَاجْعَلْنِیْ مِنَ الْمُتَطَهِّرِیْنَ

Përkthimi: O All-llah! Më bëj nga ata që pendohen shpesh dhe më bëj nga ata që rrinë të pastër.

(Suneni Tirmidhi, vëll. 1, fq. 121, Hadithi 55)

(Dërgoni salavate mbi Pejgamberin e dashur! Salavatet e All-llahut qofshin mbi Muhammedin!)

Katër Farzet e Abdestit

1. Larja e fytyrës.
2. Larja e të dy krahëve, duke përfshirë bërrylat.
3. Kalimi i dorës së lagur (mes'hi, fërkimi) mbi një të katërtën e kokës.
4. Larja e të dy këmbëve, duke përfshirë kyçet e këmbëve.

(Fetava 'Alemgiri, vëll. 1, fq. 3, 4, 5; Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 288)

Përkufizimi i 'larjes'

Larja e çdo pjese të trupit do të thotë rrjedhja e të paktën dy pikave ujë mbi çdo pjesë të saj. Nëse pjesa e trupit vetëm laget duke e fshirë me një dorë të lagur, ose nëse vetëm një pikë uji rrjedh mbi të, atëherë ajo nuk do të konsiderohet e larë dhe Abdesti ose Gusli juaj do të jetë i pavlefshëm.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 218; Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 288)

Katërmbëdhjetë Sunnetet e Abdestit

Disa veprime Sunnet dhe Mustehab janë përmendur tashmë nën temën

'Metoda e Abdestit (Sipas Medh'hebit Hanefi)'. Detaje të tjera vijojnë:

1. Nijeti.
2. Recitimi i 'بِسْمِ اللّٰه' (bismi'l-lahi). Nëse recitoni 'بِسْمِ اللّٰهِ وَالْحَمْدُ لِلّٰه' (bismi'l-lahi ue'l-hamdu li'l-lah) para Abdestit, atëherë engjëjt do të vazhdojnë të regjistrojnë vepra të mira për ju për aq kohë sa jeni me Abdest.
3. Larja e të dy duarve deri në kyçe, tri herë.
4. Përdorimi i Misvakut, tri herë.
5. Shpëlarja e gojës tri herë, duke marrë ujë me kupën e dorës (me grusht) çdo herë.
6. Bërja e gargarës, nëse nuk jeni duke agjëruar (Savm).
7. Thithja e ujit në hundë tri herë, duke përdorur ujë sa gjysma e kupës së dorës për çdo herë.
8. Bërja e khilalit (fërkimit me gishta) të mjekrës (nëse nuk jeni në gjendje Ihrami).
9. Bërja e khilalit (fërkimit) të gishtave të dorës.
10. Bërja e khilalit (fërkimit) të gishtave të këmbëve.
11. Kalimi i duarve të lagura në të gjithë kokën vetëm një herë.
12. Fshirja (bërja mes'h) e veshëve.
13. Ruajtja e rendit të Farzeve (d.m.th., larja e fytyrës në fillim, pastaj e krahëve, pastaj kalimi i duarve të lagura mbi kokë dhe pastaj larja e këmbëve).
14. Larja e një pjese të trupit përpara se të thahet ajo e mëparshmja.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 293, 294, përmbledhur)

Njëzet e nëntë Mustehabe (veprime të pëlqyeshme) të Abdestit

1. Të drejtohesh nga Kibla.

2. Të marrësh Abdest në një ndenjëse të ngritur,
3. duke qëndruar ulur.
4. Të fërkosh (fshish) me dorë pjesët e trupit ndërsa i lan ato.
5. Të marrësh Abdest me qetësi.
6. Të lagësh (njomësh) pjesët e trupit të Abdestit përpara se t'i lash ato, veçanërisht në dimër.
7. Të shmangësh marrjen e ndihmës nga dikush tjetër nëse ske nevojë.
8. Të shpëlash gojën duke përdorur dorën tënde të djathtë.
9. Të thithësh ujë në hundë duke përdorur dorën tënde të djathtë.
10. Të përdorësh dorën tënde të majtë për të pastruar hundën.
11. Të fusësh gishtin e vogël të dorës së majtë në vrimat e hundës.
12. Të lagësh (bësh mes'h) pjesën e pasme të qafës tënde duke përdorur pjesën e pasme të gishtave të tu.
13. Të fusësh gishtat e tu të vegjël të lagur në pjesën e brendshme të veshëve tuaj ndërsa fshini (bëni mes'h) veshët tuaj.
14. Të lëvizësh çdo unazë që mund të kesh veshur nëse është e lirshme dhe je i sigurt se uji ka rrjedhur poshtë saj. Megjithatë, nëse unaza është e ngushtë, atëherë lëvizja e saj është e detyrueshme (Farz) për të siguruar rrjedhjen e ujit poshtë saj.
15. Të marrësh Abdest para se të hyjë koha e Namazit, nëse nuk je një Ma'dhur sipas Sheriatit (person i arsyetuar ligjërisht). [Rregullat e detajuara në lidhje me personin Ma'dhur sipas Sheriatit përmenden në faqet në vijim].
16. Për një person që kryen Abdestin në mënyrë të përsosur, d.m.th., i cili sigurohet që asnjë pjesë të mos mbetet e palarë, është Mustehab të tregojë kujdes të veçantë gjatë larjes së këndeve të syve drejt

www.dawateislami.net

hundës, kyçeve të këmbëve, thembrave, shputave, muskujve të trashë mbi thembra, hapësirave midis gishtave dhe bërrylave. Për njerëzit e pakujdesshëm, është Farz të tregojnë kujdes shtesë me këto zona, pasi është vërejtur se pjesë të tilla shpesh mbeten të thata për shkak të pakujdesisë. Një pakujdesi e tillë është Haram dhe të qenit i kujdesshëm është Farz..

17. Të mbash ibrikun tënd të ujit në anën e majtë të trupit. Nëse përdor një enë (të gjerë), tas, etj., për Abdest, atëherë mbaje atë nga ana e djathtë.

18. Të përhapësh ujin në ballin tënd, ndërsa lan fytyrën, në mënyrë që të lash edhe një pjesë shtesë të kokës tënde mbi fytyrë.

19. Të shtosh larjen e fytyrës tënde,

20. krahëve dhe këmbëve; dmth., të lash më shumë sesa është Farz, p.sh., të lash krahët deri në gjysmën e pjesëve të sipërme të tyre mbi bërryl dhe të lash këmbët mbi kyçet e këmbëve deri në gjysmën e gjurit.

21. Të lash fytyrën tënde duke përdorur të dyja duart.

22. Të fillosh nga majat e gishtërinjve të duarve dhe këmbëve kur lan duart dhe këmbët.

23. Të fshish pikat e ujit nga çdo pjesë [e larë] e trupit me duart e tua, në mënyrë që pikat e ujit të mos bien mbi trupin ose rrobat e tua, veçanërisht kur synon të hysh në një Mesxhid. Është Mekruh Tahrimi (afër haramit) të lejosh që uji i Abdestit të pikojë në dyshemenë e Mesxhidit.

24. Të sigurohesh që ke nijetin e Abdestit ndërsa lan ose bën mes'h (fshin) çdo pjesë të trupit.

25. Të recitosh Salavat mbi Pejgamberin صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم dhe Kelime Shehadetin krahas 'بِسْمِ اللهِ' (bismi'l-lahi)-t në fillim të Abdestit.

26. Të mos i thash pa nevojë pjesët e trupit të lara. Nëse e bën, atëherë

www.dawateislami.net

shmang tharjen e tyre tërësisht; lëri ato pak të lagura, pasi kjo lagështi do të peshohet bashkë me veprat e tua të mira në Ditën e Gjykimit.

27. Të mos i shkundësh duart pas Abdestit, pasi kjo është erashka e shejtanit.

28. Të spërkasësh ujë në zonën e përparme intime të pantallonave të tua. Kur spërkat ujë në këtë zonë të pantallonave të tua, është e këshillueshme ta fshehësh pjesën e përparme të pantallonave nën këmishë. Në fakt, mbajtja e kësaj pjese të pantallonave të tua e fshehur gjatë gjithë Abdestit, dhe më saktë gjatë gjithë kohës, duke u mbuluar dyfish me këmishën, shallin etj., është më afër modestisë.

29. Të ofrosh dy rekate namaz nafile pas Abdestit, nëse nuk është kohë Mekruh. Këto dy rekatë nafile quhen Tehijjetu'l-Vudu.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 293-300)

Gjashtëmbëdhjetë Mekruhe (veprime të papëlqyeshme) gjatë Abdestit

1. Të ulesh në një vend të papastër për të marrë Abdest.

2. Të lejosh që uji i Abdestit të pikojë në një vend të papastër.

3. Të lejosh që pikat e ujit nga pjesët e tua të lagura të trupit të bien në enën e ujit etj. (Ndërsa lan fytyrën, pikat e ujit zakonisht bien në ujin në duart tuaja; kjo duhet shmangur.)

4. Të pështysh, të nxjerrësh gëlbazë ose ujë në drejtim të Kiblës.

5. Biseda e panevojshme e kësaj bote.

6. Të shpërdorosh ujë të tepërt. (Sadrus'h-Sheri'ah Mufti Muhammed Amjad 'Ali A'dhami رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه shkruan në *Behar-e-Sheri'at,* vëllimi 1, faqet 302-303: "Aq ujë sa mund të mbahet në gjysmën e grushtit të dorës është i mjaftueshëm për të thithur ujë në hundë; prandaj,

marrja e ujit sa një grusht i plotë i dorës për shpërlarjen e hundës është shpërdorim.")

7. Të përdorësh sasi uji të pamjaftueshme që pengon përmbushjen e Sunnetit. (Mos e hapni rubinetin aq shumë sa uji të shpërdorohet dhe as aq pak sa të shkaktojë vështirësi në përmbushjen e Sunnetit; përkundrazi, hapeni në një masë të arsyeshme.)

8. Të përplasësh ujin në fytyrën tënde.

9. Të frysh në ujë ndërsa e derdh mbi fytyrën tënde.

10. Të lash fytyrën tënde vetëm me një dorë. Ky është zakon i Rrafidijve dhe Hinduve.

11. Të bësh mes'h (fshish) fytin.

12. Të shpëlash gojën ose të thithësh ujë në hundë duke përdorur dorën tënde të majtë.

13. Të pastrosh hundën me dorën tënde të djathtë.

14. Të bësh mes'h (fshish) kokën tri herë me ujë të papërdorur për secilën herë.

15. Të përdorësh ujë të nxehtë të ngrohur drejtpërdrejt nga rrezet e diellit.

16. Të mbyllësh fort sytë ose buzët. Nëse ndonjë nga këto zona mbetet e palarë, atëherë Abdesti yt do të jetë i pavlefshëm. Është Mekruh të braktisësh cilindo Sunnet të Abdestit, dhe po ashtu është Sunnet të braktisësh cilëndo vepër Mekruh të Abdestit.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 300, 301)

Sqarim në lidhje me ujin e ngrohur nga dielli

Sadru'sh-Sheri'ah, Bedru't-Tarikah, 'Al-lameh Meulana Mufti Muhammed Amjad 'Ali A'dhami رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka shkruar në një shënim në fund të faqes 301, vëllimi 1, të *Behar-e-Sheri'at* (versioni i referuar i

botuar nga Mekteba-tul-Medinah): "Nuk është krejtësisht e papëlqyeshme të marrësh Abdest me ujë të ngrohur drejtpërdrejt nga dielli; përkundrazi, ka disa kushte për këtë, të cilat synoj t'i shpjegoj në kapitullin e ujit. Është Mekruh Tenzihi (papëlqyeshmëri e lehtë), jo Mekruh Tahrimi (e urryer afër Haramit)."

Në kapitullin e ujit (faqe 334) ai رَحْمَةُاللّٰهِعَلَيْه e ka sqaruar: "Uji në vendet e nxehta në mot të nxehtë, i ngrohur nga dielli në një enë metalike, përveç arit ose argjendit, nuk duhet të përdoret për Gusl ose Abdest për aq kohë sa është i nxehtë; as nuk duhet pirë. Në fakt, duhet të shmangni çdo kontakt trupor me të. Nëse një veshje është njomur me të, shmangni veshjen e saj derisa të jetë ftohur, pasi ky ujë mund të shkaktojë lebrën. Megjithatë, Abdesti ose Gusli me të është i vlefshëm."

(Behar-e- Sheri'at, vëll. 1, fq. 301, 334)

Rregull i rëndësishëm për ujin Musta'mel (e përdorur)

Nëse nuk jeni në gjendje Abdesti dhe dora juaj, maja e gishtit, thoi i dorës, thoi i këmbës ose çdo pjesë tjetër e trupit tuaj që duhet të lahet gjatë Abdestit, me ose pa dashje, bie në kontakt me ujë që mbulon më pak se sipërfaqen prej 25 jardë katrorë ose 20,9 metra katrorë (p.sh., një kovë ose vaskë me ujë), atëherë ai ujë do të bëhet Musta'mel (i përdorur) dhe nuk mund të përdoret më për Abdest ose Gusl.

Në një sitatë të ngjashme, nëse një pjesë e palarë e trupit të dikujt, për të cilin Gusli është Farz, bie në kontakt me ujin, atëherë ky ujë nuk mund të përdoret për Abdest ose Gusl. Megjithatë, nëse një dorë e larë ose një pjesë e larë e trupit tuaj bie në kontakt me ujin, atëherë kjo është në rregull.

(Behar-e-Sheri'at, pjesa 2, fq. 333)

(Ju lutemi studioni pjesën e 2-të Behar-e-Sheri'at për detaje të tjera rreth ujit Musta'mel, Abdestit dhe Guslit.)

Abdesti me ujë të turbullt

Abdesti lejohet me ujë të përzier me baltë nëse uji është ende i lëngshëm (i hollë). A'la Hadret رَحْمَةُاللّٰهِعَلَيْه ka thënë: "Por përdorimi i ujit të përzier me baltë pa nevojë është i ndaluar, pasi kjo përfshin shpërfytyrimin e fytyrës së njeriut (si pasojë e baltës), gjë që është e ndaluar (Haram)."

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 650)

(Kjo tregon se shformimi i fytyrës duke e fërkuar me baltë ose duke e nxirë, siç ndonjëherë fytyrat e hajdutëve nxihen me qymyr etj., është e ndaluar (Haram). Shformimi me qëllim i fytyrës së një jobesimtari nuk lejohet gjithashtu.)

Marrja e Abdestit me ujë në të cilin është përzier diçka me erë të keqe është Mekruh (i papëlqyeshëm). Nëse vjen erë gjatë Namazit, kjo do të jetë Mekruh Tahrimi (e urryer afër Haramit). *(Po aty, fq. 650)*

Kujdes për ata që hanë Paan (gjethe beteli)!

Mjeshtri im A'la Hadret, Imam i Ehlu's-Sunnetit, zhdukësi i Bid'atit, ringjallësi i Sunnetit, E'sh-Shah Imam Ahmad Raza Khan رَحْمَةُاللّٰهِعَلَيْه ka thënë: "Përdoruesit e varur të Paanit (veçanërisht ata me hapësira midis dhëmbëve) e dinë nga përvoja se grimcat e vogla të Paanit ngjiten në të gjitha pjesët, qoshet, zgavrat e gojës së tyre, dhe shpëlarja e gojës tri apo edhe dhjetë herë nuk ndihmon në pastrimin e tyre si duhet. Edhe një kruese dhëmbësh apo Misvak nuk mund ta zgjidhë problemin. E vetmja gjë që mund të ndihmojë është shpëlarja e përsëritur, e cila i lejon ujit të rrjedhë nëpër hapësirat dhe zgavrat e dhëmbëve e të gojës dhe gradualisht të heqë grimcat e vogla të Paanit. Nuk ka kufi për këtë. Pastrimi i plotë i gojës duhet të theksohet jashtëzakonisht shumë."

Shumë Hadithe tregojnë: "Kur një njeri ngrihet për të falur Namaz, një engjëll i vendos gojën mbi gojën e tij; çdo gjë që ai reciton del nga goja e tij dhe hyn në gojën e engjëllit. Nëse, në atë kohë, ka grimca ushqimi të ngjitura në dhëmbët e tij, engjëjt lëndohen tmerrësisht nga kjo më shumë se çdo gjë tjetër."

Pejgamberi i Shenjtë صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم ka deklaruar: "Kur ndonjëri prej jush ngrihet natën për të falur Namaz, duhet të pastrojë dhëmbët me një Misvak, sepse kur reciton Kur'anin, një engjëll i vendos gojën mbi gojën e tij, dhe çdo gjë që del nga goja e tij futet në gojën e engjëllit."

(Shu'abu'l-Iman, vëll. 2, fq. 381, nr. 2117)

Më poshtë është një rrëfim i Sejjiduna Ebu Ejjub Ensari رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ në librin Kebir të shkruar nga Imam Taberani رَحْمَۃُ اللّٰہِ عَلَیْہ: "Nuk ka asgjë më shqetësuese për dy engjëjt sesa të shohin shoqëruesin e tyre duke falur Namaz me grimca ushqimi të ngjitura midis dhëmbëve."

(El-Mu'xhemu'l-Kebir, vëll. 4, fq. 177, Hadithi 4061; Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 624-625)

Një këshillë Tesavvufi Medinase madhështore

Huxhxhetu'l-Islam, Sejjiduna Imam Muhammed Gazaliu رَحْمَۃُ اللّٰہِ عَلَیْہ ka thënë: "Kur shkoni për të falur Namaz pas marrjes së Abdestit, duhet të mendoni kështu: 'Pjesët e dukshme të trupit tim janë të pastra, por qëndrimi në gjykatën e All-llahut عَزَّوَجَلَّ pa një zemër të pastruar është i neveritshëm, pasi All-llahu عَزَّوَجَلَّ i sheh edhe zemrat.'"

Ai رَحْمَۃُ اللّٰہِ عَلَیْہ ka shtuar më tej: "Kushdo që e lan trupin e jashtëm duke marrë Abdest nuk duhet të harrojë kurrë se pastërtia e zemrës qëndron në pendim, braktisjen e mëkateve dhe adoptimin e sjelljeve të mira. Personi që nuk e pastron zemrën e tij nga ndyrësia e gjynaheve dhe i kushton vëmendje vetëm pastërtisë dhe bukurisë së jashtme është si ai që e fton mbretin në shtëpinë e tij. Ai pastron dhe lyen pjesën e jashtme të shtëpisë për të kënaqur mbretin, por nuk i kushton vëmendje pjesës së brendshme. A do të kënaqet apo nuk do të kënaqet mbreti kur të futet në shtëpi dhe ta shohë atë në një rrëmujë të plotë? Çdo person i mençur mund ta kuptojë se si do të reagonte mbreti."

(Ihjau'l-'Ulum, vëll. 1, fq. 185, përmbledhur)

Pesë rregulla mbi gjakderdhjen nga një plagë

1. Nëse ka rrjedhje gjaku, qelbi ose lëngu të verdhë që ka potencialin të rrjedhë mbi çdo pjesë të trupit që është Farz të lahet gjatë marrjes Abdest ose Gusl, atëherë Abdesti juaj do të bëhet i pavlefshëm.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 304)

2. Nëse gjaku shfaqet në sipërfaqen e trupit tuaj pa rrjedhur, për shembull, nëse ju shpon maja e një gjilpëre ose thike; ose kur përdorni një kruese dhëmbësh, Misvak ose gishtin tuaj për të pastruar dhëmbët; ose pasi kafshoni një mollë etj., vëreni një shenjë gjaku në mollë; ose nëse shihni gjurmë gjaku në gishtin tuaj pasi e keni futur në hundë, por ky gjak nuk kishte potencialin të rrjedhë, atëherë ai (gjak) nuk do të ndikojë në Abdestin tuaj.

(Po aty)

3. Nëse rrjedh, por jo në një zonë të lëkurës që është Farz të lahet gjatë marrjes Abdest ose Gusl, p.sh., keni një puçërr në syrin tuaj që plas, por lëngu mbetet brenda qepallave tuaja; ose gjaku apo qelbi mbetet brenda veshit tuaj dhe nuk ka rrjedhur jashtë veshit; atëherë Abdesti juaj nuk do të ndikohet.

(Po aty, fq. 27)

4. Edhe nëse një plagë është e madhe dhe lëngu (gjaku, qelbi) është i dukshëm, Abdesti juaj nuk do të bëhet i pavlefshëm nëse lëngu nuk rrjedh jashtë plagës.

(Po aty)

5. Nëse fshini vazhdimisht gjakun e dalë nga një plagë dhe nuk e lejoni të rrjedhë, atëherë pyesni veten nëse sasia e fshirë e gjakut kishte potencialin të rrjedhë apo jo; nëse përgjigjja është po, atëherë Abdesti juaj është i pavlefshëm, ndryshe jo.

(Po aty)

Çarjet e lëkurës për shkak të të ftohtit intensiv

Nëse keni çarje në lëkurë në pjesët e trupit, për shkak të temperaturave të ftohta, atëherë lajini ato pjesë, nëse është e mundur. Nëse uji i ftohtë shkakton dëm, përdorimi i ujit të ngrohtë është Vaxhib, nëse është e mundur. Nëse edhe uji i ngrohtë shkakton dëm, atëherë bëni mes'h (fshini) lëkurën tuaj; nëse edhe mes'hi është i dëmshëm, atëherë derdhni ujë mbi fashën ose kremin e vendosur. Nëse edhe kjo është e dëmshme, atëherë bëni mes'h me ujë mbi fashën ose kremin. Nëse edhe kjo është e dëmshme, atëherë lejohet ta lini të palarë dhe të pafshirë.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 620)

Rregulli për Abdestin në rastin e përdorimit të kënasë dhe kohlit (rimelit)

Nëse një grua nuk ishte e vetëdijshme se kishte një shtresë këna në duart ose këmbët e saj, Abdesti dhe Gusli i saj janë të vlefshëm. Megjithatë, kur ajo e kupton, duhet ta heqë atë shtresë dhe të lajë lëkurën poshtë saj.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 613)

Nëse nuk keni qenë të vetëdijshëm se ju ka mbetur pak kohl (rimel) në qoshet ose vetullat e syve tuaj, nuk ka asnjë dëm në këtë. Nëse e keni kuptuar pas përfundimit të Namazit tuaj, atëherë nuk ka absolutisht asnjë dëm.

(Po aty)

A e prishin injeksionet Abdestin?

1. Një injeksion në muskul do ta prishë Abdestin tuaj vetëm nëse ka rrjedhje gjaku që ka potencialin të rrjedhë.

2. Injeksionet në vena zakonisht kërkojnë thithjen e gjakut tuaj lart në shiringë dhe sasia e gjakut të thithur zakonisht është e mjaftueshme për të rrjedhur, prandaj këto injeksione e prishin Abdestin tuaj.

3. Ngjashëm, injektimi i glukozës së lëngshme në vena nëpërmjet një

infuzioni (serumi/IV) e prish Abdestin tuaj, pasi një sasi gjaku që mund të rrjedhë ngjitet në tub. Nëse ndonjëherë, një sasi gjaku që mund të rrjedhë nuk hyn në tub, atëherë Abdesti juaj nuk do të prishet.

4. Nxjerrja e gjakut nga trupi juaj nëpërmjet një shiringe për një analizë gjaku gjithashtu do ta prishë Abdestin tuaj, pasi është një sasi që mund të rrjedhë. Ky gjak është po aq i papastër sa urina. Namazi juaj do të jetë i pavlefshëm nëse falni Namaz me një shishe gjaku në xhepin tuaj. Është gjithashtu e ndaluar të sillni një shishe gjaku ose urine në një Mesxhid edhe nëse është e mbyllur mirë; kjo vepër do të ishte një gjynah.

Lotët e syrit të sëmurë

1. Lotët që rrjedhin për shkak të një infeksioni ose sëmundje të syve janë të papastër dhe e prishin Abdestin.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 310)

Fatkeqësisht, shumë njerëz nuk e dinë këtë gjykim dhe i fshijnë këta lotë si lotë të zakonshëm me mëngë, rroba etj., duke i bërë kështu rrobat e tyre të papastra.

2. Lëngu i rrjedhur nga syri i një të verbri për shkak të ndonjë sëmundjeje (në sy) është i papastër dhe e prish Abdestin.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 306)

Lëngu i pastër dhe i papastër

Çdo lëng që derdhet nga trupi i njeriut, por nuk e prish Abdestin, është i pastër. Shembuj janë gjaku ose qelbi që nuk ka potencial të rrjedhë, ose më pak se një gojë plot me të vjellë.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 309)

Flluskat dhe puçrrat

1. Nëse shpërtheni një flluskë dhe lëngu brenda saj rrjedh, atëherë Abdesti juaj do të bëhet i pavlefshëm; nëse nuk rrjedh nuk prishet. *(Po aty, fq. 305)*

2. Nëse një puçërr është shëruar plotësisht; kanë mbetur vetëm lëkura e vdekur e saj, e cila është e zbrazët me një hapje në krye, dhe nëse brendësia e asaj hapësire boshe mbushet me ujë dhe e shtypni për të nxjerrë ujin, atëherë as Abdesti juaj nuk do të prishet dhe as ai ujë nuk është i papastër.

3. Megjithatë, nëse brenda saj gjendeshin disa gjurmë gjaku etj., atëherë Abdesti juaj do të prishet dhe uji i nxjerrë është gjithashtu i papastër. *(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 355-356)*

4. Nëse në një puçërr ose zonë lëkure që është kruajtur nuk ka lëng që mund të rrjedhë, ka vetëm sipërfaqe të ngjitshme; atëherë pavarësisht sa herë rrobat tuaja prekin atë sipërfaqe të ngjitshme, ato do të mbeten të pastra. *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 310)*

5. Nëse nga hunda juaj del gjak i thatë, ai nuk do të ndikojë në Abdestin tuaj. Megjithatë, është preferuar ta përsërisni atë.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 281)

Kur e prish të vjellët Abdestin?

Një gojë plot me të vjella, me ushqim, ujë ose lëng tëmthi (lëng gastrik), e prish Abdestin. Të vjellat klasifikohen si e vjellë me plot gojën, kur nuk mund të ndalohen pa vështirësi. Një gojë plot me të vjella është po aq e papastër sa urina; prandaj është thelbësore të mbroni rrobat dhe trupin tuaj nga spërkatjet e saj. *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 306, 390)*

Rregullat rreth të qeshurit

1. Nëse një i rritur i cili po fal një Namaz që përmban Ruku' dhe Sexhde qesh aq me zë të lartë gjatë Namazit saqë e dëgjojnë njerëzit rreth tij,

atëherë i prishet dhe Abdesti dhe Namazi i tij bashkarisht. Nëse ai qesh dhe zërin e të qeshurës e dëgjon vetëm ai vetë, Namazi i tij do të bëhet i pavlefshëm, por Abdesti nuk do t'i prishet. Buzëqeshja nuk prish as Abdestin, as Namazin. Me buzëqeshje nënkuptohet vetëm zbulimi i dhëmbëve pa nxjerrë asnjë zë. *(Meraki'l-Felah, fq. 64)*

2. Nëse një individ i rritur qesh me zë të lartë në një Namaz xhenazeje, Namazi i tij do të bëhet i pavefshëm, por Abdesti i tij nuk prishet. *(Po aty)*

3. Edhe pse të qeshurat me zë të lartë kur nuk falni Namaz nuk e prishin Abdestin tuaj, megjithatë, është Mustehab (e pëlqyeshme) ta përsërisni atë. *(Meraki'l-Felah, fq. 60)*

Rrasulull-llahu ynë i Nderuar صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم nuk ka qeshur kurrë me zë të lartë; prandaj, ne duhet të përpiqemi ta ringjallim këtë Sunnet dhe të shmangim të qeshurat me zë të lartë. Rrasulull-llahu ynë i Dashur صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم ka thënë: 'اَلْقَهْقَهَةُ مِنَ الشَّيْطٰنِ وَالتَّبَسُّمُ مِنَ اللهِ تَعَالٰى' E qeshura me zë është nga shejtani, ndërsa buzëqeshja është nga All-llahu عَزَّوَجَلَّ.

(El-Mu'xhemu's-Saghir li't-Taberani, vëll. 2, fq. 104)

A e prish Abdestin shikimi i pjesëve intime të dikujt?

Shumë njerëz mendojnë se ekspozimi i gjunjëve ose i Auretit (pjesës intime, Setr-it)[1] të dikujt, ose shikimi i gjunjëve ose i pjesës intime të vetes ose të dikujt tjetër e prish Abdestin; ky është një keqkuptim. Megjithatë, mbajtja e zonës së Auretit të mbuluar është nga etikat e Abdestit. Në fakt, zona e Auretit duhet të mbulohet menjëherë pas larjes së organeve të jashtëqitjes në tualet. Ekspozimi i panevojshëm i zonës së Auretit është i

[1] Aureti ose Setr-i (zona e detyrueshme për ta mbuluar) për burrat përfshin zonën nga poshtë kërthizës deri te gjunjët, duke i përfshirë gjunjët.

ndaluar, dhe ekspozimi i saj përpara të tjerëve është Haram.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 309)

Abdesti gjatë Guslit është i mjaftueshëm

Kur merret Abdesti gjatë Guslit (larjes së plotë), nuk ka nevojë të përsëritet, edhe nëse keni qenë i zhveshur gjatë larjes. Në fakt, edhe nëse nuk keni marrë Abdest gjatë Guslit, do të konsideroheni sikur keni marrë, pasi pjesët e trupit [që lahen] gjatë Abdestit lahen edhe gjatë Guslit. Gjithasht, edhe ndërrimi i rrobave nuk e prish Abdestin.

Gjaku në pështymë

1. Nëse ju rrjedh gjak nga goja dhe gjaku dominon pështymën tuaj, atëherë ai do ta prishë Abdestin tuaj; nëse nuk dominon pështymën nuk prishet. Gjaku do të konsiderohet dominant nëse pështyma juaj është në ngjyrë të kuqe; në këtë rast, Abdesti juaj është prishur dhe kjo pështymë është gjithashtu e papastër. Nëse pështyma juaj është në ngjyrë të verdhë, ajo do të konsiderohet dominante ndaj gjakut; prandaj, Abdesti juaj nuk do të prishet dhe kjo pështymë nuk është e papastër.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 305)

2. Nëse gjakderdhja e gojës e ka skuqur pështymën e një personi dhe ai fut ujë në gojën e tij duke i prekur buzët në një tas ose gotë me ujë për ta shpëlarë gojën, atëherë tasi ose gota dhe i gjithë uji do të bëhen të papastër. Në një rast të tillë, ai duhet të marrë ujë me grushtin e dorës së tij dhe më pas të shpëlajë gojën, duke u kujdesur që stërpikat e ujit të papastër të mos bien në rrobat e tij etj.

Pesë rregulla mbi pasigurinë në Abdest

1. Nëse dyshoni për herë të parë në jetën tuaj nëse keni larë apo jo një pjesë të caktuar të trupit gjatë Abdestit, atëherë lajeni përsëri atë

pjesë. Nëse keni shpesh të njëjtin dyshim, injorojeni atë. Ngjashëm, nëse keni një dyshim të ngjashëm edhe pas Abdestit, injorojeni atë.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 310)

2. Nëse keni marrë Abdest, por më vonë keni rënë në dyshim nëse ai është prishur apo jo, atëherë Abdesti juaj ende është i vlefshëm, pasi dyshimi nuk e prish Abdestin.

(Po aty, fq. 311)

3. Përsëritja e Abdestit në rast të një Vesveseje (pështpëritjeje të shejtanit) nuk është masë paraprake; përkundrazi, është bindje ndaj shejtanit.

(Po aty)

4. Abdesti juaj do të ngelet i vlefshëm derisa të jeni mjaft i/e sigurt (për prishjen e tij) sa të mund të betoheni se Abdesti juaj është prishur.

5. Nëse e dini se një pjesë e trupit ka mbetur e palarë gjatë Abdestit, megjithatë nuk ju kujtohet cila, atëherë lani këmbën tuaj të majtë.

(Durru'l-Mukhtar, vëll. 1, fq. 310)

Pozicionet e gjumit që e prishin ose nuk e prishin Abdestin

Ka dy kushte për pavlefshmërinë e Abdestit për shkak të gjumit:

(1) Të dy të ndenjurat (vithet) të mos jenë të mbështetura fort në tokë.

(2) Fjetja në një mënyrë që nuk e pengon gjumin e thellë.

Nëse të dyja këto kushte bashkekzistojnë, atëherë gjumi do ta prishë Abdestin tuaj. Nëse flini në një pozicion në të cilin përmbushet vetëm një nga këto dy kushte, atëherë Abdesti juaj nuk do të prishet nga ky gjumë.

Dhjetë pozicione gjumi që nuk e prishin Abdestin:

1. Të flesh ulur me të dy të ndenjurat (vithet) të mbështetura fort në

tokë dhe të dy këmbët e shtrira drejt në të njëjtin drejtim. (Të flesh ulur në një karrige, në një ndenjëse autobusi/treni etj. është një situatë e ngjashme.)

2. Të flesh ulur përtokë me të dyja të ndenjurat (vithet) të mbështetura në tokë, dhe t'i mbështjellësh të dy kërcinjtë (pjesën e këmbës mes gjurit dhe kyçit) me duart e tua; pavarësisht nëse duart i mban të mbështetura në tokë apo nëse e mbështet kokën mbi gjunjë.

3. Të flesh ulur këmbëkryq, qoftë në tokë, në krevat ose kudo tjetër.

4. Të flesh ulur në gjunjë (si në Ka'deh gjatë Namazit).

5. Të flesh ulur mbi një kalë ose mushkë të shaluar.

6. Të flesh ulur mbi një kalë ose mushkë, pa shalë, që udhëton në një terren malor ose të sheshtë.

7. Të flesh ndërsa mbështetesh në një jastëk me të dy ndenjurat (vithet) të mbështetura fort, edhe nëse do të rrëzoheshe me heqjen e jastëkut.

8. Të flesh duke qëndruar në këmbë .

9. Të flesh në pozicionin e Rukusë.

10. Të flesh në pozicionin në të cilin burrat kryejnë Sexhden sipas Sunnetit, dmth., me barkun e ndarë nga kofshët dhe krahët e ndarë nga anët.

Gjumi në këto pozicione nuk e prish Abdestin dhe as Namazin tuaj, qoftë ai gjumë brenda apo jashtë Namazit, edhe nëse flini me qëllim. Megjithatë, çdo pjesë e Namazit që keni falur ndërsa keni qenë plotësisht në gjumë duhet të përsëritet. Nëse e keni filluar (Namazin) ndërsa ishit zgjuar pastaj ju ka zënë gjumi, pjesa që keni falur ndërsa ishit zgjuar nuk ka nevojë të përsëritet, por pjesa që ka kaluar ndërsa ishit në gjumë duhet të falet (të përsëritet).

Dhjetë pozicione gjumi që e prishin Abdestin:

1. Të flesh duke qenë ulur mbi shputat e këmbëve me gjunjët e ngritur (paralel me njëri-tjetrin dhe të ndenjurat/vithet duke mos prekur në tokë).
2. Të flesh shtrirë me shpinë.
3. Të flesh me bark poshtë.
4. Të flesh në krahun e djathtë ose të majtë.
5. Të flesh ndërsa mbështetesh në njërin bërryl.
6. Të flesh ulur duke u mbështetur në njërën anë me një ose të dy të ndenjurat (vithet), të ngritura nga toka.
7. Të flesh ulur në një kafshë pa shalë, që udhëton duke zbritur tatëpjetë nga diku (qoftë mal, kodër, majë etj.).
8. Të flesh në gjunjë (si në Teshehhud gjatë Namazit) me stomakun të shtypur mbi kofshët dhe të dy të ndenjurat (vithet), jo të mbështetura fort.
9. Të flesh ulur këmbëkryq me kokën të mbështetur në kofshë ose kërcinjë (mes gjurit dhe kyçeve).
10. Të flesh në pozicionin në të cilin femrat kryejnë Sexhden, dmth., me barkun e shtypur mbi kofshët, krahët ngjitur me anët e trupi ose parakrahët e shtrirë në tokë.

Fjetja në ndonjërin nga këto pozicione e prish Abdestin tuaj, pavarësisht nëse jeni apo jo në Namaz. Megjithatë, të fjeturit me qëllim në ndonjë nga pozicionet e përmendura do ta prishë edhe Namazin tuaj. Nëse ndodh pa dashje, prishet vetëm Abdesti, e jo Namazi.

Pas përsëritjes së Abdestit, mund ta vazhdoni Namazin (nën kushte të caktuara) nga vendi ku u ndërpre për shkak të gjumit. Nëse nuk i njeh ato kushte (të vazhdimit të Namazit), duhet ta rifillosh Namazin nga fillimi. *(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 365-367)*

Gjumi dhe Abdesti i Pejgamberëve të Bekuar

- Abdesti i Pejgamberëve të shquar عَلَيْهِمُ الصَّلٰوةُ وَالسَّلَام nuk prishet nga gjumi. Sytë e tyre flenë, por zemrat e tyre kurrë.

- Disa prishës të Abdestit nuk zbatohen për Pejgamberët e lavdishëm عَلَيْهِمُ الصَّلٰوةُ وَالسَّلَام, për shkak të faktit se është e pamundur që Pejgamberët të përfshihen në ato prishës si p.sh; çmenduria dhe e qeshura me zë të lartë gjatë Namazit.

- Pejgamberët عَلَيْهِمُ الصَّلٰوةُ وَالسَّلَام mund të bien në gjendje të fikëti vetëm fizikisht, megjithatë zemrat e tyre mbeten të zgjuara dhe të vetëdijshme.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 740)

Abdest'hanet në Mesxhid

Pastrimi i dhëmbëve me Misvak ndonjëherë mund të rezultojë në gjakderdhje që dominon pështymën tuaj, duke e bërë kështu atë të papastër. Fatkeqësisht, kjo është një çështje për të cilën shumë njerëz janë të pakujdesshëm. Zonat e Abdestit (Abdest'hanet) në Mesxhid zakonisht janë të cekëta; si rezultat, pikat e ujit nga pështyma juaj e dominuar nga gjaku mund të spërkaten në rrobat dhe trupin tuaj. Kjo është edhe më e rrezikshme gjatë marrjes së Abdestit në dyshemenë e fortë të banjës në shtëpi.

Ndërtimi i një Abdest'haneje brenda shtëpisë

Njerëzit sot kanë tendencë të marrin Abdest në lavamanë në shtëpi duke qëndruar në këmbë, gjë që është e padëshirueshme. Fatkeqësisht, njerëzit ndërtojnë vila të mëdha luksoze, por nuk mendojnë të përfshijnë ambiente të posaçme për marrjen e Abdestit. Kërkesa ime Medinase për të gjithë vëllezërit muslimanë që janë të etur të ndjekin Sunnetin është që, nëse është e mundur, të organizojnë ndërtimin e një Abdest'haneje me të paktën një rubinet në shtëpinë tuaj. Sigurohuni që uji të mos bjerë drejtpërdrejt (vertikalisht) në sipërfaqen e kanalizimit,

por të bjerë në një pjerrësi (që çon në kanalizim); përndryshe do të ngelet i njëjti rrezik i pështymës së papastër që spërkatet përsëri në rrobat dhe trupin tuaj.

Nëse dëshironi të ndërtoni një Abdest'hane me kujdes të veçantë, mund të përdorni udhëzimet e dhëna në kapakun e pasmë të kësaj broshure. Kur përdorni tualetin, pikat e ujit spërkaten zakonisht rreth nyjave të këmbëve; prandaj, si masë sigurie, duhet t'i lani nyjat e këmbëve (pas përdorimit të një tualeti tradicional aziatik).

Plani i ndërtimit për një Abdest'hane

Një Abdest'hane në shtëpi duhet të jetë **107.95 cm** e gjatë, **123.8 cm** e gjerë dhe **34.9 cm** e lartë, me një ndenjëse **19 cm** e lartë dhe **82.55 cm** e gjerë që shtrihet në gjatësinë e të gjithë strukturës.

Distanca midis ndenjëses dhe murit përpara duhet të jetë **63.5 cm**. Duhet të ketë një pjerrësi në pjesën e përparme të platformës, me kanalizimin jo më të gjerë se **19 cm**. Lini pak më shumë hapësirë sesa gjatësia e këmbëve tuaja për të qëndruar në këmbë (përafërsisht **28.6 cm**). **11.4 cm** e përparmë të kësaj zone për këmbët duhet të jenë të ashpra, në mënyrë që të ju lejojë të pastroni këmbët tuaja duke i fërkuar shputat kundër kësaj sipërfaqeje të ashpër (veçanërisht në dimër).

Vendosni një rubinet të lëvizshëm (mikser) në formë 'L' ose 'U' në një lartësi prej **81.3 cm** mbi kanalizim. Rubineti duhet të vendoset në mënyrë të tillë që rrjedha e ujit të bjerë mbi pjerrësi, duke e bërë të lehtë mbrojtjen nga gjaku që del nga goja etj. Duke ndjekur të njëjtin plan ndërtimi dhe duke bërë disa ndryshime, një Abdest'hane e tillë mund të ndërtohet edhe në Mesxhid.

Shënim: Nëse dëshironi të vendosni pllaka, atëherë vendosni pllaka të bardha, të paktën në zonën me pjerrësi, në mënyrë që çdo njollë gjaku që del nga goja juaj gjatë përdorimit të Misvakut të jetë e dukshme.

Nëntë perla Medinase rreth Abdest'hanes

1. Nëse është e mundur, përdorni planin në kapakun e pasmë të kësaj broshure për të ndërtuar një zonë për marrjen e Abdestit në shtëpinë tuaj.

2. (Pa dëgjuar sugjerimet e ndërtuesit), sigurohuni që pjerrësia e këmbës të jetë **5.08 cm** (2 inç), sipas skicës së dhënë në kapakun e pasmë të këtij libri.

3. Nëse dëshironi të instaloni më shumë se një rubinet, atëherë lini një hapësirë prej **63.5 cm** (25 inç) midis çdo seti rubinetash.

4. Rregulloni një grykë plastike etj. në rubinet sipas nevojës suaj.

5. Nëse tubi i ujit është instaluar nga jashtë murit, atëherë zhvendosni ndenjësen tuaj 3 cm ose 5 cm më tej.

6. Është më e sigurt ta testoni Abdest'hanen tuaj duke marrë Abdest një ose dy herë te ajo përpara se të finalizoni ndërtimin e saj.

7. Nëse do të instaloni pllaka në dyshemenë e Abdest'hanes ose të banjës, atëherë instaloni pllaka kundër rrëshqitjes për të minimizuar rrezikun e rrëshqitjes.

8. Duhet të shmangni vendosjen e pllakave në buzë të mbështetëses së këmbëve dhe të paktën në 5 cm të pjerrësisë; përkundrazi, lyeni atë me çimento me një buzë të ashpër dhe të rrumbullakosur, duke ju lejuar të pastroni këmbët tuaja duke i fërkuar mbi këtë sipërfaqe të ashpër.

9. Kur bëni një kanalizim në kuzhinë, banjë, tualet, çati, Abdest'hane, në Mesxhidin tuaj apo kudo tjetër ku uji mund të grumbullohet, duhet të rrisni pa hezitim pjerrësinë e dyshemesë 1.5 herë më shumë nga ajo që sugjeron ndërtuesi juaj (p.sh., nëse ai thotë 5 cm, atëherë kërkojeni t'a bëjë 7.5 cm).

Ndërtuesi juaj do të përpiqet t'ju bindë duke thënë se 'nuk ka nevojë të shqetësoheni sepse asnjë pikë uji nuk do të ngelë mbi dysheme'. Në fakt, shpesh shihet se uji mbetet duke u grumbulluar në vende të ndryshme mbi dysheme etj. Nëse lejoni që ai të ju bindë, atëherë do të rrezikoni të keni një kanalizim të pamjaftueshëm. Dhe nëse nuk i besoni atij, do t'i shihni vetë përfitimet, me lejen e All-llahut عَزَّوَجَلَّ.

Gjashtë rregulla për këdo që nuk mund ta mbajë Abdestin e tij

1. Abdesti prishet qoftë edhe nga rrjedhja e një pike urine, dalja e gazit, rrjedhja nga një plagë, rrjedhja e lotëve nga një sy i sëmurë për shkak të sëmundjes; rrjedhja e ujit nga kërthiza, veshët ose gjinjtë; rrjedhja e lëngut nga një puçërr dhe nga diarreja.

   Nëse dikush vuan vazhdimisht nga ndonjë prej këtyre sëmundjeve dhe kalon një kohë e plotë (e një Namazi Farz), nga fillimi deri në fund të kohës, pa mundur të falë një Namaz Farz me Abdest; atëherë ai është një Ma'dhur Sher'i (i arsyetuar ligjërisht). Kjo do të thotë se ai mund të falë sa Namaze të dëshirojë me një Abdest gjatë një kohe të vetme; Abdesti i tij nuk do të prishet nga ajo sëmundje. *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 385; Durru'l-Mukhtar, Rreddu'l-Muhtar, vëll. 1, fq. 553)*

   Le ta thjeshtojmë më tej këtë rregull. Pacientë të tillë, qofshin meshkuj apo femra, mund të kontrollojnë nëse janë Ma'dhur Sher'i (të arsyetuar ligjërisht) apo jo duke u përpjekur të falin të paktën rekatët Farz të Namazit të vaktit pasi të kenë marrë Abdest kurdo midis kohës së dy Namazeve Farz. Nëse, pavarësisht nga përpjekjet e përsëritura, nuk mund të falin Namaz me Abdest gjatë gjithë kohës (mes dy Namazeve Farz), dmth., ndonjëherë sëmundja që u prish Abdestin u shfaqet gjatë marrjes së Abdestit dhe ndonjëherë gjatë faljes së Namazit (duke ua prishur atë), dhe në këtë gjendje është afruar edhe koha e fundit e Namazit të vaktit gjithashtu [duke u prishur Abdesti vazhdimisht], atëherë, në një rast të tillë u lejohet

të falin Namazin pasi të kenë marrë Abdest. Namazi i tyre do të jetë i vlefshëm, [ata mund të vazhdojnë Namazin] edhe nëse papastërtia derdhet nga trupi i tyre për shkak të asaj sëmundjeje (kronike) gjatë Namazit.

Juristët Islamë رَحِمَهُمُ اللّٰهُ kanë thënë se nëse dikujt i rrjedh gjak nga hunda ose i rrjedh lëng nga plaga, ai duhet të presë deri në kohën e fundit të Namazit. Nëse gjaku nuk ndalet (për më tepër rrjedh vazhdimisht ose herë pas here), ai duhet të falë Namazin përpara se të përfundojë koha. *(El-Bahru'r-Rraik, vëll. 1, fq. 373-374)*

2. Abdesti i një Ma'dhuri (të arsyetuari) bëhet i pavlefshëm kur përfundon koha e Namazit Farz. Për shembull, nëse dikush merr Abdest në kohën e Ikindisë (ʻAsrit), Abdesti i tij do të bëhet i pavlefshëm pas perëndimit të diellit. Nëse dikush merr Abdest pas lindjes së diellit, Abdesti i tij do të mbetet i vlefshëm derisa të dalë koha e Drekës, sepse koha e asnjë Namazi Farz nuk ka përfunduar ende. Ma'dhur Sher'i e humb Abdestin e tij kur përfundon koha e Namazit Farz. Ky rregull zbatohet kur shkaku i ʻUdhrit (dmth., arsyetimit) gjendet gjatë Abdestit ose pas Abdestit. Nëse nuk gjendet shkaku dhe nuk ka asnjë arsye tjetër që e prish Abdestin, atëherë Abdesti nuk do të bëhet i pavlefshëm edhe pas kalimit të kohës së Namazit Farz. *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 386; Durru'l-Mukhtar, Rreddu'l-Muhtar, vëll. 1, fq. 555)*

3. Sapo konfirmohet ʻUdhri (arsyeja), ai do të mbetet i vlefshëm për aq kohë sa shkaku (kronik i prishjes së Abdestit) shfaqet të paktën një herë në kohën e plotë të Namazit. Për shembull, nëse dikush përjeton një rrjedhje të vazhdueshme pikash urine në një kohë të plotë Namazi dhe nuk i jepet mundësia të marrë Abdest dhe të falë Namazin Farz të kohës, ai është Ma'dhur (i arsyetuar). Tani, në kohët vijuese, nëse ai gjen mundësinë të marrë Abdest dhe të falë Namaz (pa iu prishur Abdesti), por gjatë këtyre periudhave, edhe nëse i rrjedhin vetëm një ose dy pika urinë, ai është ende Ma'dhur (i arsyetuar).

Megjithatë, nëse kalon e gjithë koha e një Namazi Farz pa rrjedhur asnjë pikë urinë, atëherë ai nuk është më Ma'dhur (i arsyetuar). Nëse rikthehet gjendja e mëparshme (dmth., sëmundja kronike i rikthehet gjatë gjithë kohës së një Namazi Farz), ai përsëri do të bëhet Ma'dhur (i arsyetuar). *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 385)*

4. Abdesti i një Ma'dhuri (të arsyetuari) nuk prishet nga sëmundja që e bëri Ma'dhur (të arsyetuar); megjithatë, nëse i ndodh ndonjë prishës tjetër i Abdestit, Abdesti do të bëhet i pavlefshëm. Për shembull, nëse dikush ka një sëmundje (kronike) të daljes së vazhdueshme të gazrave; Abdesti i tij do të prishet nëse urinon. Ngjashëm, nëse dikush ka një sëmundje të daljes së vazhdueshme të pikave të urinës, atëherë Abdesti i tij do të bëhet i pavlefshëm nëse i del gaz. *(Po aty, fq. 586)*

5. Nëse një Ma'dhur (i arsyetuar) merr Abdest pas shfaqjes së një prishësi tjetër të Abdestit (veç sëmundjes kronike) dhe gjatë Abdestit arsyeja (sëmundja) për të cilën ai klasifikohet si Ma'dhur (i arsyetuar) nuk shfaqet, por pastaj, pasi mori Abdest, shfaqet ajo arsye (sëmundje e tij), atëherë Abdesti i tij do të prishet përsëri.

   (Ky rregull zbatohet kur një Ma'dhur/i arsyetuar mori Abdest për shkak të një situate tjetër që prish Abdestin përveç arsyes (sëmundjes) për të cilën është Ma'dhur/i arsyetuar. Nëse ai merr Abdest për shkak të 'Udhrit/arsyetimit të tij nga sëmundja kronike, Abdesti nuk do të prishet nëse ai 'Udhr/arsyetim nga sëmundja i ndodh edhe pas Abdestit). Për shembull, dikush ishte Ma'dhur (i justifikuar) për shkak të rrjedhjes së vazhdueshme të pikave të urinës; ai mori Abdest për shkak të daljes së gazrave. Gjatë Abdestit nuk pati rrjedhje pikash urine, por pas Abdestit i dolën disa pika urine; në këtë rast, Abdesti i tij do të prishet. Megjithatë, nëse kjo rrjedhje pikash urine i ndodhi gjatë marrjes së Abdestit, atëherë Abdesti i tij do të mbetet i vlefshëm. *(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 387; Durru'l-Mukhtar, Rreddu'l-Muhtar, vëll. 1, fq. 557)*

6. Nëse 'Udhri (arsyetimi) është i tillë që i bën rrobat të bëhen të papastra dhe njolla e papastërtisë në rrobë është më e madhe se madhësia e një dirhemi (apo 100 lek-shi metalik), dhe gjendet mjaft kohë për ta pastruar rrobën dhe për të falur Namazin me rroba të pastra, atëherë është Farz për ju të falni Namazin me rroba të pastra.

   Nga ana tjetër, nëse jeni të sigurt se gjatë faljes së Namazit, rrobat tuaja do të bëhen përsëri të papastra në të njëjtën masë (më të madhe se madhësia e një dirhemi), atëherë pastrimi i rrobave tuaja nuk është i nevojshëm. Ju mund të falni Namazin me këto rroba, edhe nëse sexhadja juaj ku do faleni është njollosur; Namazi juaj do të jetë përsëri i vlefshëm.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 387)

(Për rregulla të detajuara në lidhje me Abdestin e një Ma'dhuri/të arsyetuari, ju lutemi referojuni librit Fetava Razavijjeh, vëllimi 4, faqet 367 deri 375, Behar-e-Sheri'at, vëllimi 1, faqet 385 deri 387)

Shtatë vendime të ndryshme

1. Dalja e urinës, jashtëqitjes, spermës, krimbave ose gurëve nga organi gjenital ose nga organi i jashtëqitjes i një burri ose gruaje e prish Abdestin.

   ('Alemgiri, vëll. 1, fq. 9)

2. Edhe dalja e një sasie të vogël gazi nga organi i jashtëqitjes të një burri ose gruaje e prish Abdestin. Dalja e gazit nga organi gjenital i një burri ose i një gruaje nuk e prish Abdestin. *(Po aty; Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 304)*

3. I fikëti e prish Abdestin. *('Alemgiri, vëll. 1, fq. 12)*

4. Disa njerëz besojnë se thënia e fjalës 'derr' e prish Abdestin; kjo është gënjeshtër.

5. Nëse Abdesti juaj prishet për shkak të daljes së gazit ose ndonjë arsyeje tjetër gjatë marrjes së Abdestit, atëherë rifilloni Abdestin tuaj nga e para; organet tuaja të lara më parë tani konsiderohen të palara. *(Fetava Razavijjeh, vëll. 1, fq. 255)*

6. Është Haram të prekësh pa Abdest Kur'anin e Shenjtë, çdo Ajet Kur'anor ose përkthimin e tij në çfarëdo lloj gjuhe.

(Behar-e-Sheri'at, vëll. 1, fq. 326, 327 etj.)

7. Nuk ka asnjë problem të recitosh Kur'anin e Lavdishëm pa Abdest duke e parë atë ose përmendësh, pa e prekur.

Vendim i rëndësishëm mbi prekjen e një letre me një Ajet Kur'anor në të

Në një libër ose gazetë, kudo që shkruhet një Ajet Kur'anor, nuk lejohet të preket as ana e përparme, e as ana e pasme e atij Ajeti. Megjithatë, nuk ka asnjë dëm të preket ndonjë pjesë tjetër e asaj letre. Recitimi i ndonjë Ajeti pa Abdest është i lejueshëm; por nëse keni nevojë për Gusl të detyrueshëm edhe recitimi përmendësh është Haram (i ndaluar). All-llahu عَزَّوَجَلَّ e di më së miri.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 366)

Nuk lejohet prekja e Kur'anit të Lavdishëm nga asnjë anë pa Abdest

Prekja e një Ajeti pa Abdest është e ndaluar (Haram) edhe nëse ai Ajet është shkruar në një libër (jo Kur'an). Për më tepër, është Haram të preket hapësira boshe në çdo anë të faqeve të Kur'anit të Shenjtë ose pëlhura apo lëkura që i është ngjitur kopertinës së tij duke e ngjitur ose qepur. Megjithatë, prekja e kutisë së Kur'anit Kerim lejohet. Pa Abdest nuk ju lejohet ta prekni Kur'anin e Lavdishëm as me gjoksin tuaj.

Nëse dikush pa Abdest ka vendosur njërin skaj të një shalli të gjatë në qafë dhe dëshiron ta prekë Kur'anin e Lavdishëm me skajin tjetër të

shallit që ka në dorën e tij, atëherë kjo lejohet nëse shalli është aq i gjatë saqë skaji tjetër nuk do të lëvizë kur ai të ulet ose të ngrihet; ndryshe, prekja e Kur'anit Kerim nuk lejohet.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 4, fq. 724, 725)

Shpërdorimi i ujit gjatë Abdestit

Në ditët e sotme, shumë njerëz shpërdorojnë shumë ujë duke i hapur rubinetat më tepër se duhet. Ajo që është edhe më e keqe është se disa njerëz i hapin rubinetat sapo arrijnë në zonën e marrjes së Abdestit, përpara se të fillojnë t'i përveshin mëngët, duke shpërdoruar kështu shumë ujë.

Ngjashëm, shumë njerëz i lënë rubinetat hapur ndërsa bëjnë mes'h (fshijnë) kokat e tyre. Ne të gjithë duhet t'i frikësohemi All-llahut عَزَّوَجَلَّ dhe të shmangim një shpërdorim të tillë, sepse në Ditën e Gjykimit do të jemi përgjegjës për çdo pikë dhe grimcë. Këtu janë katër Hadithe që dënojnë shpërdorimin e ujit. Lexojini ata dhe dridhuni nga frika e All-llahut عَزَّوَجَلَّ:

1. Shpërdorimi në përrua

Pejgamberi i Dashur صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم kaloi pranë Sejjiduna Sa'dit رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ ndërsa ky i fundit po merrte Abdest. Rrasuli i Dashur صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم vërejti: "Pse po e shpërdoroni ujin?" "A ka shpërdorim të ujit edhe në Abdest?"- pyeti me respekt Sejjiduna Sa'di رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ. "Po ka, edhe sikur të merrni Abdest në një përrua që rrjedh."- u përgjigj Ai صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم.

(Suneni Ibn Maxhe, vëll. 1, fq. 254, Hadithi 425)

Fetvaja e A'la Hadretit

A'la Hadret, Imam i Ehlu's-Sunnetit رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه e sqaron këtë Hadith të bekuar: "Ky Hadith argumenton se shpërdorimi i ujit është i mundur edhe në një lumë që rrjedh, dhe shpërdorimi dënohet nga Sheriati. Kur'ani i Lavdishëm thotë:

وَلَا تُسْرِفُوْا ؕ اِنَّهٗ لَا یُحِبُّ الْمُسْرِفِیْنَ ﴿۱۴۱﴾

Dhe mos shpërdoroni. Vërtet, Ai nuk i do shpërdoruesit.

[Kenzu'l-Iman (Përkthimi i Kur'anit)] (Pjesa 8, El-En'am, Ajeti 141)]

Ky Ajet është i përgjithshëm; prandaj, edhe ky shpërdorim (në Abdest) dënohet dhe ndalohet. Në fakt, ekziston një ndalim për 'shpërdorimin në Abdest', dhe ndalimi çon në deklarimin e diçkaje si Haram.

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 731)

Tefsiri (komentari) i Mufti Ahmed Jar Khanit

Një komentues i njohur (Mufessir i Kur'anit Famëlartë), Mufti Ahmed Jar Khan رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه e shpjegon Ajetin e cituar nga A'la Hadreti رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه (Ajeti 141 i Sures El-En'aam) kështu: "Shpenzimi për gjëra të ndaluara është shpërdorim; dhurimi i të gjithë pasurisë suaj, duke e bërë në këtë mënyrë familjen tuaj të varfër, është gjithashtu përdorim i pahijshëm i pasurisë; shpenzimi më shumë sesa kërkohet është gjithashtu shpërdorim; prandaj, edhe larja e pjesëve të trupit gjatë Abdestit katër herë (pa arsye Sheriatike) është konsideruar si shpërdorim.

(Nuru'l-'Irfan, fq. 232)

2. Mos e shpërdoroni ujin

Sejjiduna 'Abdull-llah Bin 'Umer رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُمَا transmetoi se: "Pejgamberi ynë i Dashur صَلَّی اللّٰہُ عَلَیْہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم vërejti dikë duke marrë Abdest dhe urdhëroi: 'Mos shpërdoro, mos shpërdoro.'"

(Sunen Ibn Maxhe, vëll. 1, fq. 254, Hadithi 424)

3. Shpërdorimi është vepër djallëzore

Sejjiduna Enesi رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ transmetoi se: "Nuk ka asgjë të mirë në përdorimin e një sasie të madhe uji gjatë marrjes Abdest; kjo është nga shejtani.

(Kenzu'l-'Ummal, vëll. 9, fq. 144, Hadithi 26255)

4. Duke kërkuar një pallat të bardhë në Xhennet?

Sejjiduna 'Abdull-llah Ibn Mughaffel رَضِیَ اللّٰہُ عَنْہُ dëgjoi djalin e tij duke thënë lutjen e mëposhtme: "O All-llah عَزَّوَجَلَّ, të lutem për një pallat të bardhë në anën e djathtë të Xhennetit." Atëherë i ati i tha: "Bir! Kërkoi All-llahut عَزَّوَجَلَّ Xhennetin dhe kërkoi strehim prej Tij nga Zjarri. Kam dëgjuar Rrasulull-llahun صَلَّی اللّٰہُ عَلَیْہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم duke thënë se disa njerëz nga Ummeti im do t'i tejkalojnë kufijtë në Abdest dhe në lutje (Dua)."

(Ebu Davud, vëll. 1, fq. 68, Hadithi 96)

Komentuesi i famshëm, mendimtari i madh i Ummetit, Mufti Ahmed Jar Khan رَحْمَۃُ اللّٰہِ عَلَیْہ e sqaroi këtë Hadith kështu: "Tejkalimi i kufijve të Duasë (lutjes) i referohet specifikimeve të panevojshme siç bëri djali i tij. Është më mirë të kërkoni Firdeusin (nivelin më të lartë të Xhennetit). Ky nuk është specifikim personal i dikujt, por është specifikim i një lloji. Kjo është urdhëruar.

(Mirr'atu'l-Menexhih, vëll. 1, fq. 293)

E keqja dhe padrejtësia

Një beduin pyeti Pejgamberin e Nderuar صَلَّی اللّٰہُ عَلَیْہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم se si duhej të merrte Abdest. Ai صَلَّی اللّٰہُ عَلَیْہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم i demonstroi metodën e tij, në të cilën lau çdo pjesë të bekuar të trupit tri herë. Ai صَلَّی اللّٰہُ عَلَیْہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم më pas vërejti duke thënë: "Kështu duhet të merret Abdesti; kushdo që shton ose pakëson në këtë ka kryer të keqe dhe padrejtësi."

(Sunen Nesai, fq. 31, Hadithi 140)

Shpërdorimi është gjynah vetëm në dy raste

Mësuesi im A'la Hadreti رَحْمَۃُ اللّٰہِ عَلَیْہ ka shkruar: "Thënia e mësipërme është një paralajmërim për personin që i lan pjesët e trupit më shumë se tri herë, duke besuar se larjet shtesë janë Sunnet. Megjithatë, nëse ai beson se larja tri herë është Sunnet, por i lan pjesët e trupit më shumë se tri herë për të përsëritur Abdestin e tij, ose për t'u siguruar kur ka

dyshime, ose për t'u freskuar, ose për të pasur pastërti, ose nëse i lan më pak se tri herë për ndonjë nevojë, atëherë nuk ka asnjë dëm në këtë. Shpërdorimi është i ndaluar dhe gjynah vetëm në dy raste: (1) Shpenzimi dhe përdorimi i diçkaje për një gjynah dhe (2) shpërdorimi i pasurisë pa ndonjë arsye.

Larja e pjesëve të trupit më shumë se tri herë në Abdest ose Gusl sigurisht nuk është shpërdorim nëse bëhet për një qëllim të vlefshëm, sepse shpenzimi për një shkak të lejueshëm nuk është as gjynah dhe as shpërdorim i kotë."

(Fetava Razavijjeh, vëll. 1, fq. 940 deri 942)

Mësoni Abdestin praktikisht

Vëllezër të dashur muslimanë! Hadithi i mësipërm tregon se vetë Pejgamberi i Nderuar صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم i dha beduinit një demonstrim praktik të Abdestit. Duke vepruar sipas këtij Hadithi, predikuesit duhet t'ua demonstrojnë vëllezërve muslimanë metodën e marrjes së Abdestit, duke larë çdo pjesë të nevojshme të trupit vetëm tri herë, pa shpërdoruar ujin. Kini kujdes që të mos lani asnjë pjesë të trupit katër herë pa një arsye të vlefshme. Pastaj, kushdo që dëshiron të korrigjojë gabimet e tij, duhet t'i japë predikuesit një demonstrim të Abdestit.

Kjo praktikë Medinase mund të kryhet në mënyrë të shkëlqyer në shoqërinë e të dashurve të Rrasulull-llahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم gjatë Karvaneve Medinase frymëzuese të Sunnetit të Davet-e-Islami. Është shumë e rëndësishme që ju të mësoni metodën e saktë të marrjes së Abdestit. Është shumë e vështirë të kuptohet metoda e saktë e Abdestit vetëm duke e lexuar atë një ose dy herë; ajo kërkon praktikë të përsëritur.

Departamenti i botimeve të Davet-e-Islami, Maktaba-tul-Medinah, ka nxjerrë një DVD me titull 'Metoda e Abdestit'. Do ta gjeni shumë të dobishme për të mësuar rreth Abdestit.

Shpërdorimi i ujit të Mesxhidit dhe Medresesë

Rregulli i 'Vakfit' (fondeve të dhuruara) zbatohet për ujin në Mesxhid dhe Medrese. Ka një ndryshim në rregullat e ujit të Vakfit (të dhuruar) dhe ujit shtëpiak. Njerëzit që shpërdorojnë ujin pa kujdes në Mesxhid, ose që pa nevojë i lajnë pjesët e trupit më shumë se tri herë gjatë marrjes Abdest nga padituria ose pakujdesia, duhet të mendojnë rreth Fetvasë së bekuar të mëposhtme, të dridhen nga frika e All-llahut عَزَّوَجَلَّ dhe të pendohen.

A'la Hadreti, Imam i Ehlu's-Sunnetit, Imam Ahmed Raza Khan رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه ka thënë: "Dijetarët janë dakordësuar unanimisht se është Haram të përdorësh më shumë sesa sasia e nevojshme e ujit të Vakfit për marrjen e Abdestit, pasi nuk lejohet ta përdorësh këtë ujë më shumë sesa kërkohet. I njëjti rregull vlen edhe për ujin në Medresetë Islame. Ai është dhururar (lënë Vakf) vetëm për njerëzit që marrin Abdest sipas Sheriatit."

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 658)

Vëllezër të dashur muslimanë! Kushdo që nuk mund të përmbahet nga shpërdorimi i ujit duhet të përdorë ujin e tij personal, dmth., duhet të marrë Abdest në shtëpinë e tij. All-llahu عَزَّوَجَلَّ na ruajtë! Kjo nuk do të thotë se ju lejohet të shpërdoroni aq ujë personal sa dëshironi, por më tepër ju duhet të mësoni mënyrën e marrjes së Abdestit sipas rregullave Sheriatike duke e praktikuar atë në shtëpi, për të shmangur kryerjen e një vepre Haram duke shpërdoruar ujin e Mesxhidit.

Shtatë udhëzime nga A'la Hadreti për të shmangur shpërdorimin

1. Disa njerëz e mbushin ujin në duart e tyre në një mënyrë që uji derdhet jashtë tyre. Uji i derdhur shpërdorohet. Duhet pasur kujdes në lidhje me këtë.

2. Nuk është e nevojshme të përdoret një grusht plot me ujë çdo herë. Duhet të bëhet një vlerësim rreth sasisë së ujit të nevojshëm për

qëllime të ndryshme. Për shembull, vetëm gjysmë grushti ujë është i mjaftueshëm për të thithur në pjesën e butë të hundës suaj. Nuk është i nevojshëm një grusht i plotë me ujë as për shpëlarjen e gojës.

3. Gryka e enës së ujit (ibrikut) duhet të jetë me madhësi të moderuar, dmth., as aq e ngushtë sa uji mezi rrjedh dhe as aq e gjerë sa uji të derdhet më shumë se sa kërkohet. Mund të vëreni se përdoret ujë më tepër se duhet kur Abdesti merret me një tas. Ngjashëm, një rubinet i gjerë do të shkaktojë përdorim të tepërt të ujit. Nëse ena (ibriku) juaj ka një grykë të gjerë, kini kujdes dhe mos e lini të rrjedhë me një rrjedhë të fortë ujin; përkundrazi, derdhni ujin me një rrjedhë të hollë. (Masa paraprake të ngjashme duhet të merren gjatë hapjes së rubinetave.)

4. Lagni pjesët e trupit tuaj duke përdorur dorën e lagur përpara se t'i lani ato; kjo do të lejojë përdorim të shpejtë dhe minimal të ujit. Kjo është veçanërisht e dobishme në dimër pasi lëkura zakonisht është e thatë dhe është vërejtur se rrjedha e ujit lë disa zona të thata.

5. Duhet të hiqni qimet e parakrahëve (nëse keni), pasi ato do të rrisin sasinë e ujit që duhet për larjen e tyre. Rrujtja e tyre do t'i bëjë ato të forta; prandaj, prerja me një makinë është më e mirë pasi siguron heqjen e duhur të qimeve. Metoda më e preferuar është përdorimi i pluhurit për heqjen e qimeve (i quajtur Nurah), pasi kjo është e miratuar nga Sunneti.

   Ummu'l-Mu`minin Sejjidutuna Ummu's-Seleme رَضِیَ اللّٰہُ عَنۡہَا ka transmetuar: "Sa herë që Rrasulull-llahu صَلَّی اللّٰہُ عَلَیۡہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم përdorte Nurah (pluhur depilimi), Ai صَلَّی اللّٰہُ عَلَیۡہِ وَاٰلِہٖ وَسَلَّم e aplikonte atë në Avretin (Setrin) e Tij në trupin e bekuar me duart e Tij të bekuara, dhe në pjesët e tjera të trupit të Tij të bekuar aplikohej nga bashkëshortet e Tij të bekuara."

   (Sunen Ibn Maxhe, vëll. 4, fq. 226, Hadithi 3751)

   Nëse nuk e bëni këtë, atëherë mund t'i lagni këto qime përpara se t'i lani ato për t'i sheshuar plotësisht; përndryshe, nëse uji rrjedh në

rrënjët e ndonjë qimeje të ngritur por nuk rrjedh mbi majat e qimeve, atëherë Abdesti juaj do të jetë i pavlefshëm.

6. Nëse përdorni një enë uji për Abdest, rrjedha e ujit duhet të rrjedhë nga thonjtë tuaj drejt bërrylave dhe nyjave të këmbëve në mënyrë të njëtrajtshme, në mënyrë që të gjitha pjesët të lahen vetëm një herë në një kalim të vetëm; përndryshe, lëvizja e ngadaltë e dorës suaj do të rezultojë në derdhjen e ujit në të njëjtin vend disa herë (gjë që do të jetë shpërdorim).

7. Disa njerëz e derdhin ujin nga thonjtë e tyre drejt bërrylave ose nyjave të këmbëve dhe më pas e lënë ujin të rrjedhë ndërsa e sjellin përsëri tek thonjtë e tyre për të filluar një larje të dytë dhe më pas e sjellin përsëri (me ujin që rrjedh ende) për një larje të tretë, ndërsa në fakt kjo rezulton në larjen e asaj pjese të lëkurës pesë herë në vend të tri herëve.

   Kur uji arrin në bërrylat ose nyjat e këmbëve tuaja, ndaloni rrjedhjen e ujit për secilën herë. Sille dorën tënde tek thonjtë dhe rifillo derdhjen e ujit nga thonjtë tuaj drejt bërrylave ose nyjave të këmbëve. Sunneti është të lahen nga thonjtë drejt bërrylave/nyjave të këmbëve, jo anasjelltas (nga bërrylat/nyjat drejt thonjve).

   Vendimi gjithëpërfshirës për këtë çështje është se duhet të jeni i arsyeshëm. Imam Shafiu رَحْمَةُ اللّٰهِ عَلَيْه me të drejtë ka thënë: "Me moderim, pak është e mjaftueshme; pa moderim, as sasia e bollshme nuk mjafton."

(Fetava Razavijjeh referuar, vëll. 1, fq. 765-770)

Katërmbëdhjetë perla Medinase për të shmangur shpërdorimin e ujit

1. Pendohuni për të gjitha shpërdorimet e paligjshme të së kaluarës dhe bëni çdo përpjekje të mundshme për t'i shmangur ato në të ardhmen.

2. Mendoni dhe planifikoni mirë, në mënyrë që të merrni Abdest dhe Gusl sipas Sunnetit, duke përdorur një sasi minimale uji në të njëjtën kohë. Paralajmëroni veten me faktin se duhet të jepni llogari për çdo pikë dhe grimcë të vogël në Ditën e Gjykimit. All-llahu عَزَّوَجَلَّ deklaron në xhuzin 30 të Sures Ez-Zilzal, Ajetet 7 dhe 8:

فَمَنْ يَّعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَّرَهٗ ۝ وَ مَنْ يَّعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَّرَهٗ ۝

Kushdo që bën një vepër të mirë sa pesha e një grimce, do ta shohë atë. Dhe kushdo që bën një vepër të keqe sa pesha e një grimce, do ta shohë atë.

[Kenzu'l-Iman (Përkthimi i Kur'anit)]

3. Gjatë Abdestit, hapeni rubinetin me kujdes. Gjatë Abdestit, mbajeni njërën dorë mbi rubinet aq sa të mundni dhe vazhdoni ta mbyllni rubinetin kur uji nuk ju nevojitet.

4. Nëse Abdesti merret me një enë uji (ibrik) përdoret më pak ujë krahasuar me përdorimin e një rubineti. Merrni Abdest duke përdorur një enë uji nëse është e mundur. Nëse nuk mund ta shmangni përdorimin e një rubineti, atëherë mund të lani disa pjesë të trupit duke përdorur një ibrik, nëse është e përshtatshme. Përdorimi i një rubineti për marrjen e Abdestit është i lejueshëm; megjithatë, duhet të merren të gjitha masat e mundshme për t'u përmbajtur nga shpërdorimi [i ujit].

5. Bëjeni zakon ta mbyllni rubinetin plotësisht në mënyrë që asnjë pikë uji të mos rrjedhë gjatë përdorimit të Misvakut, shpëlarjes së gojës, gargarës, pastrimit të hundës, bërjes së Khilalit të mjekrës, duarve, këmbëve; dhe mes'hit (fshirjes) së kokës.

6. Shmangni derdhjen e ujit të ftohtë [për të pritur ujin e ngrohtë] për Abdest, Gusl, larjen e rrobave, enëve etj. Kushtojini vëmendje kësaj çështjeje veçanërisht në dimër. Mund ta shmangni shpërdorimin e këtij uji të ftohtë duke e grumbulluar atë në ndonjë lloj ene (për përdorim të mëvonshëm).

7. Gjithashtu, përdorni ujin me kujdes kur bëni duart me shkumë për të pastruar duart ose fytyrën. Për shembull, për të larë duart, fillimisht duhet të merrni disa pika uji në duart tuaja dhe më pas të merrni sapunin përpara se të formoni shkumën. Nëse e hapni rubinetin me sapunin tashmë në duart tuaja, do të përdorni më shumë ujë se nevojitet.

8. Pas përdorimit, vendosni sapunin tuaj në një mbajtëse sapuni plotësisht pa ujë. Vendosja e sapunit në ujë do të shkaktojë shkrirjen dhe shpërdorimin e tij. Mos e lini sapunin tuaj as në anët e lavamanit tuaj, për të njëjtën arsye.

9. Në vend që ta hidhni ujin e mbetur në një gotë pasi që keni pirë, ofrojani dikujt tjetër ose përdoreni për ndonjë qëllim tjetër të mirë.

10. Në këtë kohë, njerëzit shpërdorojnë pa nevojë shumë ujë ndërsa lajnë fruta, rroba, enë, dysheme, filxhanë çaji ose lugë çaji. Kjo është vërtet një pamje shumë zemërthyese për çdo individ të ndjeshëm dhe të përgjegjshëm.

Shpresoj që sugjerimet e mia të gjejnë vend në zemrën tuaj.

11. Në shumicën e Mesxhideve, shtëpive, zyrave, dyqaneve etj., dritat, kondicionerët, ventilatorët ngelin të ndezur pa nevojë ditë e natë. Bëjeni zakon t'i fikni dritat, ventilatorët, kondicionerët, kompjuterët pas përdorimit, kur nuk keni më nevojë për ta. Ne të gjithë duhet të frikësohemi nga gjykimi në botën tjetër dhe të përmbahemi nga të gjitha format e shpërdorimit.

12. Përdorni një enë uji (ibrik) në tualet pasi dushi i dorës konsumon më shumë ujë dhe zakonisht do t'ju njollosë këmbët. Të gjithë duhet të spërkasin pak ujë në buzët e WC-së çdo herë që urinojnë dhe gjithashtu duhet të derdhin pak ujë në vrimën e WC-së nga një lartësi (duke i mbrojtur rrobat nga spërkatjet e ujit të ndotur). Nëse do All-llahu عَزَّوَجَلَّ, kjo do të ndihmojë në heqjen e erës së keqe dhe në parandalimin e rritjes së baktereve. Kasetat e shkarkimit (cisternat) konsumojnë shumë ujë. إِنْ شَآءَ اللّٰه عَزَّوَجَلَّ

13. Nëse keni një rubinet që pikon vazhdimisht, duhet të merrni masa të menjëhershme për ta riparuar atë; përndryshe uji do të vazhdojë të shpërdorohet. Ndonjëherë, rubinetat në Mesxhid dhe Medrese pikojnë vazhdimisht, por askush nuk kujdeset për to. Drejtuesit duhet të marrin masa të menjëhershme për riparim, duke përmbushur përgjegjësinë e tyre për përmirësimin e jetës së tyre të përtejme.

14. Kini shumë kujdes kur hani, kur pini çaj ose pije të tjera, kur prisni fruta etj., në mënyrë që të përdoret çdo grimcë ushqimi dhe çdo pikë pijeje pa u shpërdoruar.

Një buqetë me 40 perla Medinase

Të gjitha këto urtësi Medinase janë marrë nga faqet 613 deri 646 të 'Feua`id-i-Xhelileh' që përmbahen në vëllimin e katërt të Fetava Razavijjeh të referuar.

1. Nuk duhet t'i mbyllni sytë fort gjatë Abdestit. Megjithatë, nëse dikush e bën këtë, Abdesti i tij do të jetë ende i vlefshëm.

2. Nëse Abdesti merret duke i mbyllur buzët fort pa shpëlarë gojën, ai nuk do të jetë i vlefshëm.

3. Uji i Abdestit do të vendoset në peshoren e veprave të mira në Ditën e Gjykimit. (Mbani mend! Përdorimi i ujit me tepricë është Israf/shpërdorim.)

4. Nëse Misvaku është i disponueshëm, atëherë pastrimi i dhëmbëve me gishta nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur Sunnetin dhe për të fituar shpërblim. Megjithatë, nëse Misvaku nuk është i disponueshëm, atëherë pastrimi i dhëmbëve me një gisht ose një copë pëlhure të ashpër është i mjaftueshëm për të përmbushur Sunnetin. Për gratë, pastrimi i dhëmbëve me pluhur bimor është i mjaftueshëm edhe nëse Misvaku është i disponueshëm.

5. Nëse dikush mban një unazë të lirshme, atëherë larja e lëkurës poshtë saj duke e lëvizur unazën është Sunnet. Nëse unaza është e

ngushtë dhe uji nuk mund të arrijë poshtë saj pa e lëvizur atë, atëherë larja e lëkurës poshtë unazës duke e lëvizur (ose hequr) atë është Farz. Rregulli vlen edhe për vathët etj.

6. Larja e pjesëve të trupit duke i fërkuar ato tërësisht është Sunnet si në Abdest ashtu edhe në Gusl.

7. Gjatë larjes së pjesëve të trupit gjatë Abdestit, është Vaxhib t'i lani ato pak më shumë sesa kufiri minimal i përcaktuar nga Sheriati, në mënyrë që të mos ketë dyshim nëse ato janë larë apo jo deri në kufirin minimal të përcaktuar nga Sheriati.

8. Braktisja e shpëlarjes së gojës ose thithjes së ujit në hundë gjatë Abdestit është Mekruh. Ai që e ka bërë zakon këtë do të jetë gjynahqar. Ata që nuk e shpëlajnë gojën në atë mënyrë që çdo pjesë e gojës deri në fyt të lahet, si dhe ata që vetëm e prekin grushtin e ujit në hundë pa e thithur atë, janë të gjithë gjynahqarë. Nëse ky gabim bëhet gjatë Guslit, atëherë as Gusli as Namazi nuk do të jenë të vlefshëm. Duhet ta mbani mend gjithmonë këtë rregull.

9. Gjatë Abdestit, është Sunnetu'l-Muekkedeh (Sunnet i fortë) të lahet plotësisht çdo pjesë e trupit tri herë. Ai që e ka zakon ta lërë pas dore këtë Sunnet do të jetë gjynahqar.

10. Nuk duhet të marrësh Abdest me nxitim. Përkundrazi, merreni me qetësi dhe kujdes. Ka një keqkuptim të zakonshëm se duhet të marrësh Abdest si një i ri [dmth., shumë shpejt] dhe të falësh Namaz si një i vjetër [dmth., shumë ngadalë]. Kjo nuk është e saktë për Abdestin.

11. Gjatë larjes së fytyrës, nuk duhet të fillohet as duke hedhur ujë në faqe, as në hundë. As nuk duhet të hidhet ujë në ballë me forcë duke e përplasur, pasi të gjitha këto janë praktika të injorantëve. Ajo që duhet bërë është të derdhni ujë butësisht mbi pjesën e sipërme të ballit në mënyrë që uji të rrjedhë poshtë deri te mjekra.

12. Gjatë Abdestit, nëse uji që pikon nga fytyra bie mbi krah – për

www.dawateislami.net

shembull – dhe e lë ujin të rrjedhë mbi krah pa e larë krahun veçmas – Abdesti nuk do të jetë i vlefshëm. Për sa i përket Guslit, rregulli është i ndryshëm. Për shembull, uji i derdhur mbi kokë do të pastrojë të gjithë zonën mbi të cilën rrjedh (edhe nëse rrjedh mbi gjithë trupin). Nuk ka nevojë të lahet ajo zonë me ujë të papërdorur.

13. Nëse dikush ulet për të marrë Abdest por nuk mund ta përfundojë për shkak të ndonjë pengese, ai do të fitojë shpërblim për çdo veprim që ka bërë deri në atë moment edhe nëse Abdesti është i paplotë.

14. Ai që tashmë kishte synuar të merrte vetëm gjysmën e Abdestit nuk do të fitojë shpërblim për ato gjymtyrë që ka larë. Ngjashëm, ai që ulet për të marrë Abdest dhe nuk e përfundon atë pa ndonjë arsye të vlefshme, nuk meriton të shpërblehet për gjithë ato vepra që kishte bërë (gjatë marrjes së Abdestit).

15. Nëse mbi kokën e dikujt bien aq shumë pika shiu saqë një e katërta e saj laget, Mes'hi [fshirja مَسْح] do të jetë i vlefshëm edhe nëse personi nuk e ka prekur kokën as nuk ka pasur ndërmend ta bënte.

16. Nëse pika vese bien mbi kokën e zbuluar, duke lagur një të katërtën e saj, Mes'hi [fshirja مَسْح] do të jetë i vlefshëm.

17. Është Mekruh të marrësh Abdest me ujë aq të nxehtë ose aq të ftohtë sa nuk mund të derdhet si duhet mbi trup, duke e bërë të pamundur përmbushjen e Sunnetit. Nëse ndonjë Farz nuk përmbushet për shkak të gjendjes së këtij uji, Abdesti nuk do të jetë i vlefshëm.

18. Përdorimi i ujit pa ndonjë qëllim ose derdhja e tij është Haram. (Ata që hedhin ujin e mbetur të gotës ose të ibrikut pasi që kanë pirë vetë ose pasi që ka pirë dikush tjetër, duhet të pendohen dhe të përmbahen nga kjo në të ardhmen.)

19. Nëse rrjedh lëng i verdhë nga kërthiza, Abdesti do të prishet.

20. Nëse rrjedh gjak ose qelb brenda syrit dhe nuk ka rrjedhur jashtë syrit, Abdesti do të ngelet i vlefshëm. Nëse ai (gjak ose qelb) fshihet

www.dawateislami.net

me një copë pëlhure dhe pëlhura futet në ujë, uji nuk do të ndotet.

21. Nëse një plagë është e fashuar, por fasha është e njollosur me gjak etj. në një sasi të tillë saqë ajo do të kishte rrjedhur nëse plaga nuk do të ishte fashuar, atëherë Abdesti do të prishet; në të kundërt, as Abdesti nuk do të prishet dhe as fasha nuk do të bëhet e papastër.

22. Nëse dikush ndjen sikur një pikë urine do të dalë nga organi gjenital mashkullor, ose gjaku etj. rrjedh brenda organit gjenital mashkullor, Abdesti nuk do të prishet derisa pika e urinës (ose gjaku) nuk del jashtë nga vrima e organit. Nëse urina vetëm shfaqet në vrimën e penisit, kjo do ta prishë Abdestin.

23. Fëmijët e mitur [dmth., ata që nuk kanë arritur pubertetin] nuk e humbasin kurrë Abdestin dhe Guslin e tyre. Ata këshillohen të marrin Abdest dhe Gusl në mënyrë që të mësojnë sjelljen, duke e bërë zakon marrjen e Abdestit dhe Guslit. Asnjë veprim që e prish Abdestin normalisht nuk e prish Abdestin e tyre; e as Gusli nuk është Farz për ta në rastin e marrëdhënieve intime.

24. Nëse një person që është me Abdest lan rrobat e prindërve të tij ose lan fruta për t'i ngrënë ata, ose dyshemenë e Mesxhidit për të fituar shpërblim, uji do të mbetet i papërdorur; edhe pse këto vepra janë kryer me nijet për kënaqësinë Hyjnore.

25. Nëse një fëmijë i mitur e zhyt dorën e pastër ose ndonjë pjesë tjetër të trupit të tij në ujë edhe nëse nuk ka marrë Abdest, ai ujë do të ngelet i përdorshëm për Abdest (nuk konsiderohet i përdorur).

26. Mbajtja e trupit të pastër dhe pastrimi i ndyrësirave këshillohen nga Sheriati, pasi Islami bazohet në pastërti. Nëse dikush që ka Abdest e lan trupin e tij me qëllim për Abdest (mbi Abdest), ai patjetër do të fitojë shpërblim; dhe uji do të mbetet i papërdorur.

27. Uji i përdorur është i pastër dhe mund të përdoret për të larë rrobat. Megjithatë, nuk mund të merret Abdest me ujë të përdorur. Të pish ujë të përdorur ose të ngjeshësh brumin me të është Mekruh

(Tenzihi/ i lehtë).

28. Nëse dikush ka vjedhur ujin e dikujt tjetër ose e ka marrë në posedim me forcë, pa leje, megjithëse Abdesti me këtë ujë do të jetë i vlefshëm, kjo vepër është Haram. Megjithatë, nëse dikush ka mbushur/marrë ujë nga një pus pavarësisht se i ndalohet nga pronari i tij, lejohet ta përdorë këtë ujë.

29. Është më mirë të mos marrësh Abdest me ujin në të cilin kanë rënë spërkatjet ose pikat e ujit të përdorur.

30. Në rastin e marrjes së Abdestit gjatë dimrit, nëse dikush ka frikë se do të fillojë ndihet pa qejf dhe do të ftohet rëndë por nuk ka rrezik për ndonjë sëmundje, atëherë Tejemmumi nuk lejohet.

31. Shejtani pështyn dhe fryn duke bërë që personi që fal Namaz të dyshojë se i ka dalë ndonjë pikë urine dhe se i ka dalë gaz. Rregulli në këtë rast është se personi që fal Namaz nuk duhet t'i kushtojë vëmendje kësaj pështpëritje djallëzore nëse nuk është aq i sigurt saqë mund të betohet se Abdesti i tij është prishur. Nëse shejtani i thotë: "Abdesti yt është prishur"; ai duhet t'i përgjigjet në zemër: "O shejtan! Ti je gënjeshtar." Ai duhet të vazhdojë të falë Namazin.

32. Është Vaxhib të mbrohet Mesxhidi nga çdo gjë e neveritshme, edhe nëse është e pastër, si pështyma, gëlbaza, shkuma e gojës, mukusi, uji që rrjedh nga hunda dhe nga uji i Abdestit.

33. Këshillë: Pas kryerjes së Abdestit, disa njerëz e fshijnë fytyrën dhe krahët me duart e tyre dhe më pas i shkundin duart në Mesxhid [duke bërë që pikat e ujit të bien në dyshemenë e Mesxhidit]. Kjo është Haram dhe e ndaluar.

34. Të urinosh në ujë është Mekruh (e urryer) absolutisht, edhe nëse je në lumë.

35. Nëse ndonjë papastërti ndodhet diku, është Mekruh të recitosh Kur'anin e Shenjtë në atë vend.

www.dawateislami.net

36. Shpërdorimi i ujit është Haram.

37. Shpërdorimi i pasurisë është Haram.

38. Marrja e Abdestit dhe Guslit me ujë Zemzem është e lejuar. Nëse dikush ka përdorur gurë (për tharje pas urinimit etj.), është Mekruh (e urryer) të lahen organet e jashtëqitjes etj. me ujë Zemzem. Larja e papastërtive nga organet e jashtëqitjes me ujë Zemzem (për shembull, larja e organit urinar pas urinimit me ujë Zemzem pa e tharë atë me letër higjienike) është gjynah.

39. Israfi (shpërdorimi) që është i ndaluar (Haram) dhe gjynah mund të ndodhë në njërin dy kushtet e mëposhtme: (1) Të shpenzosh diçka për një gjynah. (2) Të shpërdorosh pasurinë pa ndonjë arsye.

40. Nëse disa njerëz i lajnë xhenazen një personi të vdekur për t'ua mësuar të tjerëve pa pasur nijet (qëllim) t'ia lajnë xhenazen, personi i vdekur do të pastrohet dhe Farzi (pra larja e xhenazes) do të konsiderohet gjithashtu i përmbushur nga njerëzit e gjallë. Veprimi i qëllimshëm i larjes së xhenazes është i mjaftueshëm. Megjithatë, pa nijet nuk do të merret asnjë shpërblim (për veprën).

يَارَبِّ الْمُصْطَفٰى O Zoti i Mustafasë صَلَّى اللّٰهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم! Na dhuro aftësinë të ruhemi nga shpërdorimi i ujit dhe të qëndrojmë gjithmonë me Abdest që është konform Sheriatit.

Kushdo që vdes me Abdest është dëshmor

Nëse keni mundësi të gjendeni me Abdesti gjatë gjithë kohës, atëherë bëjeni këtë, sepse grada e dëshmorit (shehadetit) regjistrohet për këdo që është me Abdest kur shpirti i tij merret nga engjëlli i vdekjes.

(Shu'abu'l-Iman, vëll. 3, fq. 29, Hadithi 2783)

Muhammed Iljas Attar Kadiri

5 Dhu'l-Hixhxheti'l-Haram, 1435 Hixhri (1 tetor 2014)

◆◆◆

www.dawateislami.net

Këshillë për lindje të lehtë (Lulja e Zonjës Merjeme)

Kur fillojnë dhimbjet e lindjes, vendosni një 'lule të zonjës Merjeme'[1] në një enë me pak ujë ose në një vaskë të hapur; sa më shumë të laget, aq më shumë do të hapet. Me mirësinë e All-llahut عَزَّوَجَلَّ dhe begatinë e kësaj luleje të zonjës Merjeme, kjo do të bëhet shkak për një lindje të lehtë.

Lindje pa operacion

(Përfitimi i lules së zonjës Merjeme)

Më poshtë është një deklaratë nga një vëlla musliman Muderris Medeni nga Xhami'atu'l-Medineh: "Me rastin e lindjes së fëmijës tim të dytë, bashkëshortja ime gjendej në dhomën e lindjes në spital. Pak më vonë, mora lajmin e lindjes së djalit tim Medeni. Në dhomën e pritjes së spitalit, fola me një burrë i cili rastësisht përmendi lulen e zonjës Merjeme. Pas interesimit tim, ai më tha se pas fillimit të dhimbjeve të lindjes, nëse e vendosni këtë lule të thatë në në një enë me pak ujë ose në një kuti të hapur me ujë, sa më shumë të laget, aq më shumë hapet, dhe avantazhi i saj është se e bëhet shkak për lindje të lehtë.

Rreth dy vjet më vonë, bashkëshortja ime priste fëmijën tim të tretë. Doktoresha i tha bashkëshortes sime se duhet të ishte psikologjikisht e përgatitur për një operacion. Mu kujtua lulja Merjem. Prandaj bleva një nga një shitës bimësh.

Kur u afrua koha e lindjes, e vendosa lulen brenda një ene. Me mirësinë e All-llahut عَزَّوَجَلَّ, vajza ime Medeni lindi pa operacion.

Edhe me lindjen e fëmijës sonë të katërt, doktoresha ishte e sigurt se do

[1] Njihet edhe si **"bima e Merjemes"** ose **"pëllëmba e Merjemes"** pasi, kur është e thatë, duket si pëllëmbë dore. Mund ta gjeni në dyqanet e bimëve mjekësore. Gjithashtu është e mundur ta bleni nga gratë dhe fëmijët vendas që e shesin në tokë në Mekë Mukerrameh dhe në Medinë Muneuuerrah. Pasuesit e devotshëm të Rrasulull-llahut صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَاٰلِهٖ وَسَلَّم që janë në dijeni të veçantisë dhe begative të saj, e sjellin me vete si send të shenjtë dhe si dhuratë. Shpjegimi i mënyrës së përdorimit është thelbësor përpara se t'ia jepni dikujt. Sa më të freskëta të jenë, aq më mirë.

www.dawateislami.net

të duhej një operacion, por përsëri përdora një lule Merjem, përveç lutjeve të tjera [të përmendura në librin 'Garajlu Ilaxh'(Gharaylu Ilaj) të Maktaba-tul-Medinah] dhe, përsëri, me hirin (mirësinë) e All-llahut عَزَّوَجَلَّ, patëm një tjetër vajzë Medeni pa operacion.

Përafërsisht dy vjet më vonë, bashkëshortja ime priste fëmijën tonë të pestë dhe përsëri u konsultuam me një doktoreshë e cila na tha, duke u bazuar në raporte të shumta mjekësore dhe në përvojë personale, se duhet të përgatiteshim për një operacion. Arrita të siguroj para për shpenzimet e operacionit dhe gjithashtu bëra shumë lutje dhe përsëri vendosa një lule Merjem në pak ujë brenda një ene të hapur.

Pavarësisht faktit se doktoresha bëri çdo përpjekje të mundshme për të shmangur operacionin, ajo më në fund tha se ishte i pashmangshëm. Tërheqa paratë nga llogaria ime bankare nga një ATM pranë spitalit dhe i depozitova ato tek arka e spitalit. Por përpara se të kryhej ndonjë operacion, me hirin (mirësinë) e All-llahut عَزَّوَجَلَّ, mora lajmin e mirë të lindjes së një djali Medeni të shëndetshëm pa operacion.

E kam rekomanduar përdorimin e luleve Merjem për katër ose pesë vëllezër muslimanë. Shumë prej tyre u këshilluan për operacione nga doktorët, por اَلْحَمْدُ لِلّٰه عَزَّوَجَلَّ (El-Hamdu li'l-lahi Azze ue Xhel-le) u bekuan me fëmijë pa kaluar sprovat e operacioneve.

Abdest'hanja e Attarit

Imazhi i Abdest'hanes nga lart



Imazhi i Abdest'hanes nga ana e djathtë



Aalami Madani Markaz, Faizan-e-Madinah, Mahallah Saudagaran
UAN +92 21 111 25 26 92 0313-1139278
www.maktabatulmadinah.com / www.dawateislami.net
feedback@maktabatulmadinah.com / ilmia@dawateislami.net